



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË DEPOZITARIT
QENDROR TË TITUJVE

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 90, datë 31.05.2023
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr.119, datë 25.07.2025

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i kërkesave dhe procedurës për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së Depozitarit Qendror të Titujve.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 224, pika 7, nenit 226, pika 9 dhe nenit 227, pika 10, të ligjit nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet nga Depozitari Qendror i Titujve, (DQT) në përputhje me dispozitat e nenit 211 e vijues të Ligjit.

Neni 4 Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **“Mospërbushje”** në lidhje me një pjesëmarrës, është situata e hapjes së procedurave së paaftësisë paguese ndaj pjesëmarrësit;
2. **“Pjesëmarrës”** nënkupton çdo pjesëmarrës në sistemet e shlyerjes së titujve;
3. **“Periudhë rishikimi”** është periudha e rishikimit që fillon në ditën pas përfundimit të periudhës së mëparshme të rishikimit dhe vlerësimit;
4. **“Sistemi i klerimit dhe shlyerjes së titujve”** është sistemi sipas përcaktimeve të ligjit “Për sistemin e pagesave”;
5. **“Menaxhim i lartë/funksionarë kryesorë”** janë personat fizikë që ushtrojnë funksione ekzekutive në një DQT, të cilët janë përgjegjës për administrimin e aktivitetit të përditshëm të DQT-së dhe llogaridhënës përpara Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës;
6. **“Shlyerje”** është përfundimi/realizimi i një transaksioni ose përpunimi me qëllim përmbushjen e detyrimeve të pjesëmarrësve nëpërmjet transferimit të fondeve dhe/ose titujve;
7. **“Mosshlyerja”** është mos kryerja e shlyerjes ose shlyerja e pjesshme e një transaksioni të titujve në datën e synuar të shlyerjes, për shkak të mungesës së titujve ose “cash-it” pavarësisht shkakut;
8. **“Cash”** janë paratë e kredituara në një llogari në çfarëdo lloj valute apo pretendime të ngjashme të ripagueshme të parave, të tilla si depozitat monetare.

KREU II

PROCEDURA PËR LICENCIMIN E DEPOZITARIT QENDROR TË TITUJVE (DQT)

Seksioni 1

Kushtet dhe procedurat për licencimin e DQT

Neni 5

Licencimi i DQT

1. Asnjë person juridik nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e Depozitarit Qendror të Titujve, nëse ky person nuk është i licencuar nga Autoriteti.
2. Aplikimi për licencim duhet të specifikojë shërbimet bazë të renditura në nenin 211, të Ligjit dhe shërbimet ndihmëse jo bankare të lejuara sipas nenit 212 të Ligjit, për të cilat DQT është e licencuar t’i ofrojë.
3. DQT duhet të përmbushë gjatë gjithë kohës kushtet e nevojshme për licencim në përputhje

me Ligjin dhe këtë rregullore.

4. DQT si dhe audituesi ligjor, duhet të informojnë, pa vonesa Autoritetin për çdo ndryshim thelbësor që ndikon në përputhshmërinë me kushtet për licencim.

Neni 6

Procedura për dhënien e licencës

1. Çdo aplikant për të vepruar si DQT duhet të dorëzojë në Autoritet kërkesën për licencim sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën I të kësaj rregulloreje.
2. Aplikanti paraqet kërkesën pranë Bankës së Shqipërisë për licencimin si operator i sistemit të shlyerjes së titujve në përputhje me dispozitat e Ligjit për sistemin e pagesave dhe rregulloreve në zbatim të tij.
3. Kërkesa për licencim pranë Autoritetit duhet të shoqërohet me të gjitha informacionet e nevojshme, siç përcaktohet në ligj dhe në këtë rregullore. Kërkesa për licencim do të përcaktojë llojin e shërbimeve, për të cilat aplikanti kërkon të licencohet, si dhe strukturën organizative të DQT-së.
4. Brenda 30 ditësh pune nga marrja e aplikimit, Autoriteti vlerëson nëse aplikimi është i plotë. Nëse aplikimi nuk është i plotë, Autoriteti cakton një afat kohor prej 10 ditësh pune brenda të cilit aplikanti për DQT duhet të depozitojë dokumentacion shtesë ose të japë informacione shtesë.
- 4/1. Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kritereve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga personat e përcaktuar në këtë rregullore, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.
5. Depozitari Qendror i Titujve nuk mund të ofrojë shërbime ndihmëse të natyrës bankare nëse nuk ka marrë autorizim shtesë për të ofruar shërbime të tilla në përputhje me ligjin në fuqi “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.
6. Brenda 6 muajsh nga paraqitja e aplikimit të plotë, Autoriteti miraton ose refuzon me vendim të arsyetuar kërkesën për licencim.

Neni 7

Efektet e licencimit

DQT duhet të kryejë vetëm shërbimet, për të cilat është licencuar dhe që specifikohen në licencën e dhënë nga Autoriteti.

Neni 8

Zgjerimi dhe delegimi i veprimtarive dhe shërbimeve

1. DQT duhet të marrë miratimin e Autoritetit, pasi ka marrë miratimin paraprak nga Banka e Shqipërisë, nëse kërkon të delegojë një shërbim tek një palë e tretë sipas kësaj rregulloreje ose kërkon të zgjerojë veprimtaritë e saj në një ose më shumë nga sa vijon:
 - a) Shërbime kryesore shtesë të listuara në nenin 211 të Ligjit, të cilat nuk mbulohen nga licencimi fillestar;

- b) Shërbime ndihmëse të lejuara sipas nenit 212 që nuk mbulohen nga licencimi fillestar;
 - c) Funkzionimin e një sistemi tjetër për shlyerjen e titujve;
 - d) Shlyerjen e të gjithë ose një pjese të segmentit monetar të sistemit të shlyerjes së titujve nëpërmjet një agjenti tjetër shlyerjeje.
2. Autoriteti miraton ose refuzon me vendim të arsyetuar kërkesën e DQT për zgjerimin e veprimtarisë dhe delegimin e shërbimeve brenda tre muajve nga paraqitja e dokumentacionit të plotë, sipas nenit 42 të kësaj rregulloreje.

Neni 9

Mbikëqyrja dhe rregullimi i sistemit të shlyerjes së titujve

Autoriteti dhe Banka e Shqipërisë, me marrëveshje dypalëshe, përcaktojnë rolin e secilit institucion, në lidhje me rregullimin, mbikëqyrjen dhe inspektimin e sistemit të shlyerjes së titujve.

Seksioni 2

Aplikimi për licencë si DQT

Nënseksioni 1 – Informacioni i Përgjithshëm

Neni 10

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin

1. Aplikimi për licencim duhet të identifikojë qartë aplikuesin për DQT, veprimtaritë dhe shërbimet që synon të kryejë.
2. Aplikimi për licencim duhet të përfshijë informacionet e mëposhtme:
 - a) Të dhënat e personit përgjegjës për aplikimin;
 - b) Emrin e subjektit aplikues, ekstraktin e regjistrit tregtar, dhe adresën e regjistruar në Republikën e Shqipërisë;
 - c) Aktin e themelimit, statutin ose çdo dokument tjetër të barazvlefshëm;
 - d) Identifikimin e sistemeve të shlyerjes së titujve që operon ose synon të operojë aplikuesi për DQT;
 - e) Kopje të vendimit të organit drejtues për aplikimin për licencim si DQT;
 - f) Një listë që përfshin:
 - (i) Emrin e çdo personi ose subjekti që drejtpërdrejtë ose tërthorazi, zotëron 5% ose më shumë të kapitalit ose të drejtave të votës të aplikuesit për DQT;
 - (ii) Emrin e çdo personi ose subjekti që mund të ushtrojë ndikim të drejtëpërdrejtë mbi administrimin e aplikuesit për shkak të zotërimit të tij në kapitalin e aplikuesit;
 - (iii) Listën e shërbimeve kryesore që aplikuesi për DQT synon të ofrojë në përputhje me nenin 211 të Ligjit;

- (iv) Listën e shërbimeve ndihmëse që aplikuesi për DQT synon të ofrojë në përputhje me nenin 212 të Ligjit;
- (v) Listën e shërbimeve dhe veprimtarive që aplikuesi për DQT ka kontraktuar ose synon të kontraktojë tek një palë e tretë në përputhje me nenin 45 të kësaj rregulloreje.
- g) Monedhën ose monedhat që aplikuesi përdor ose synon të përdorë në lidhje me shërbimet që do të ofrojë pavarësisht nëse “cash-i” është shlyer në një llogari të bankës qendrore, një llogari DQT, ose një llogari në një bankë të caktuar;
- h) Informacion mbi çdo proces gjyqësor, administrativ, arbitrazhi, në pritje dhe përfundimtar, ose çdo proces tjetër ligjor në të cilin aplikuesi për DQT është palë dhe që mund t’i shkaktojë kosto financiare ose kosto të tjera.

Neni 11

Informacioni në lidhje me politikat dhe procedurat

1. Aplikim për licencim për DQT duhet të specifikojë informacion mbi politikat dhe procedurat si më poshtë:
 - a) Pozicionin e punës dhe përgjegjësinë e personave përgjegjës për miratimin dhe zbatimin e politikave dhe procedurave;
 - b) Një përshkrim të masave që zbatohen për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat.
2. Aplikim për licencim duhet të përfshijë përshkrimin e procedurave të vendosura nga aplikuesi për DQT në përputhje me nenin 38, pika 5, të kësaj rregulloreje.

Nënseksioni 2

Burimet financiare për ofrimin e shërbimeve nga aplikuesi për DQT

Neni 12

Informacion mbi raportet financiare, planin e biznesit dhe planin e vijimësisë së biznesit

1. Aplikimi për licencim, në përputhje me nenet 54 dhe 55 të kësaj rregulloreje duhet të përfshijë informacionet si më poshtë:
 - a) Pasqyrat financiare të tre viteve të fundit, si dhe raportin e audituesit ligjor mbi pasqyrat financiare vjetore dhe të konsoliduara të tre viteve të fundit,
 - b) Kur aplikuesi për DQT auditohet nga një auditues i jashtëm, emrin dhe të dhënat e audituesit të jashtëm,
 - c) Planin e biznesit, minimumi për tre vitet e para të aktivitetit, përfshirë përshkrimin e veprimtarisë së subjektit, perspektivat e zhvillimit të veprimtarisë, pritshmëritë e subjektit mbi veprimtarinë që do të kryejë.
 - d) Dokumentin bankar që vërteton derdhjen e kapitalit minimal fillestar prej 50,000,000 Lekë.
2. Kur informacioni financiar historik i referuar në shkronjën a) të pikës 1 të këtij neni nuk është i disponueshëm, aplikimi për licencim duhet të përfshijë informacionet e mëposhtme:

- a) Dëshmi që tregon burime të mjaftueshme financiare për 6 muajt e parë të veprimtarisë pas dhënies së licencimit,
 - b) Një raport financiar të ndërmjetëm nëse është i disponueshëm.
3. Pasqyrat në lidhje me situatën financiare të aplikuesit për DQT, duke përfshirë pasqyrat e pozicionit financiar, ku jepet një pamje e drejtë dhe e vërtetë e situatës, pasqyrat e të ardhurave gjithëpërfshirëse, ku jepet një pamje e drejtë dhe e vërtetë e fitimit ose e humbjes për vitin ushtrimor, pasqyrat e ndryshimeve në kapitalin aksionar, pasqyrat e flukseve monetare si dhe një përshkrim të politikave kontabël, që ka zbatuar subjekti gjatë hartimit të pasqyrave financiare. Aplikimi duhet të përfshijë përshkrimin e detajuar të planit të vijimësisë së biznesit, duke përfshirë:
- a) Masat për të siguruar vazhdimësinë e operacioneve thelbësore;
 - b) Identifikimin e operacioneve thelbësore si dhe masat për tu bërë ballë situatave të jashtëzakonshme;
 - c) Skenarët e “stress testit”;
 - d) Një vlerësim të çfarëdo ndikimit të planit të vijimësisë të rikuperimit tek palë të treta të interesuara që mund të preken nga zbatimi i tij.

Nënseksioni 3 – Kërkesat organizative

Neni 13

Informacion mbi strukturën organizative

1. Aplikimi për licencim si DQT duhet të përfshijë një përshkrim të detajuar të strukturës organizative. Struktura organizative duhet të përcaktojë mënyrën e organizimit të brendshëm dhe rolin e organeve drejtuese e të administratorëve
2. Struktura organizative duhet të ndajë dhe të caktojë qartë përgjegjësitë e funksionarëve kryesorë, si dhe të krijojë një sistem të brendshëm efektiv të shpërndarjes së informacionit.

Neni 14

Informacion mbi procedurat e brendshme dhe masat e monitorimit të rrezikut

1. Aplikimi për licencim duhet të përfshijë informacion mbi strukturën e brendshme dhe masat e monitorimit të rrezikut si më poshtë:
 - a) Një përshkrim të rregullave qeverisëse të aplikuesit për DQT të krijuar në përputhje me nenin 38 të kësaj rregulloreje;
 - b) Politikat, procedurat dhe sistemet e përcaktuara për zbatim në përputhje me nenin 41 të kësaj rregulloreje;
 - c) Një përshkrim të përbërjes, rolit dhe përgjegjësisë të anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe të komiteteve të krijuara në përputhje me nenin 39 të kësaj rregulloreje.

2. Aplikuesi për DQT duhet të bëjë publike procedurën që rregullon organizimin e brendshëm dhe rregulloret e veprimtarisë operacionale.

Neni 15

Informacioni për Këshillin e Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës, administratorin dhe aksionarët

1. Në aplikimin për licencim, subjekti duhet të përfshijë, për çdo anëtar të menaxhimit të lartë dhe çdo anëtar të organit drejtues, informacionet e mëposhtme:
 - a) Dokument identifikimi ID/pasaportë;
 - b) Një kopje të një Curriculum Vitae, e cila përcakton përvojën dhe njohuritë e secilit anëtar;
 - c) Diplomë, kualifikime, trajnime dhe dokumenta të tjera me rëndësi që vërtetojnë arritjet akademike dhe profesionale;
 - d) Dokumentacion të lëshuar nga organet kompetente, si më poshtë:
 - (i) Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
 - (ii) Vërtetim nga prokuroria për hetim penal në proces;
 - (iii) Vërtetim nga gjykata për çështje gjyqësore në proces;
 - (iv) Dokument lidhur me procese ekzekutimi të detyrueshëm apo për detyrime pasurore të pashlyera;
 - e) Një vetëdeklarim të të gjithë anëtarëve të organit të lartë drejtues dhe menaxhues se nuk:
 - (i) Kanë qenë anëtarë të organit drejtues ose drejtues të lartë të një shoqërie, regjistrimi ose licenca e së cilës është tërhequr nga një organ rregullator ose që kanë qenë të lidhur me shoqëri të paktën një vit përpara datës së tërheqjes së autorizimit ose regjistrimit;
 - (ii) U është refuzuar e drejta për të kryer çdo lloj aktiviteti që kërkon regjistrim ose licencim nga një organ rregullator;
 - (iii) Kanë qenë anëtarë të organit drejtues ose menaxhimit të lartë të një shoqërie që i është nënshtruar një sanksioni nga një organ rregullator, është përfshirë, ka bashkëpunuar ose është i lidhur me humbje financiare, të shkaktuara nga veprimet e pandershme, të papërgjegjshme apo neglizhente, në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe administrimin e shoqërive të tjera; ose
 - (iv) Ka zotëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, të paktën 50% të të drejtave të votës apo të kapitalit të një shoqërie tregtare, ose ka qenë administrator i një shoqërie tregtare, e cila është bërë objekt i procedurave të falimentimit, në zbatim të ligjit për falimentimin;
 - (v) Është përfshirë në ndonjë praktikë tregtare, përfshirë edhe evazionin fiskal dhe pastrimin e parave, që Autoriteti e konsideron të papërshtatshme, qoftë e ligjshme ose jo, e cila hedh dyshime për mënyrën e kryerjes së shërbimeve financiare apo të veprimtarive të tjera tregtare nga ky person.
2. Aplikimi për licencim duhet të përfshijë informacion në lidhje me strukturën e pronësisë dhe aksionarët e subjektit, si më poshtë:

- a) Të dhëna mbi strukturën e kapitalit të personit juridik deri në aksionarin e fundit;
- b) Të dhënat e parashikuara në shkronjën a), plotësohen edhe nga aksionarët e aksionarit person juridik, që zotërojnë mbi 25% të aksioneve me të drejtë vote.

Neni 16 **Informacioni mbi konfidencialitetin**

1. Aplikimi për licencim duhet të përfshijë politikat dhe procedurat për parandalimin e përdorimit të paautorizuar ose zbulimit të informacionit konfidencial. Politikat dhe procedurat për ruajtjen e informacionit konfidencial duhet të përfshijnë:
 - a) Informacion në lidhje me pjesëmarrësit, klientët, emetuesit ose përdoruesit e tjerë të shërbimeve të DQT;
 - b) Informacione të tjera të mbajtura nga DQT si rezultat i veprimtarisë së saj të biznesit që nuk lejohet të përdoret për qëllime tregtare.
2. Aplikimi për licencim duhet të përfshijë informacionin në lidhje me aksesin e personelit në informacionin që mbahet nga DQT si më poshtë:
 - a) Procedurat e brendshme në lidhje me dhënien e aksesit në informacion që sigurojnë akses të sigurt në të dhëna;
 - b) Një përshkrim të çfarëdo kufizimi në përdorimin e të dhënave për arsye konfidencialiteti.

Neni 17 **Informacion mbi komitetin e përdoruesve**

Aplikimi për licencim duhet të përfshijë informacion për Komitetin e përdoruesve, si më poshtë:

- a) Mandatin e Komitetit të përdoruesve;
- b) Mënyra e organizimit të Komitetit të përdoruesve;
- c) Procedurat operative të Komitetit të përdoruesve;
- d) Kriteret e pranimit dhe mekanizmin e zgjedhjes për anëtarët e Komitetit të përdoruesve;
- e) Listën e anëtarëve që propozohen në Komitetin e përdoruesve dhe një përshkrim të interesave që ata përfaqësojnë.

Nënseksioni 4 – Rregullat e Etikës në biznes

Neni 18 **Informacionet mbi kriteret për pjesëmarrje në DQT**

1. Aplikimi për licencim duhet të përfshijë të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me pjesëmarrjen në sistemet e shlyerjes së titujve DQT në përputhje me nenin 220 të Ligjit, përfshirë sa vijon:
 - a) Kriteret e pjesëmarrjes që lejojnë akses të drejtë dhe të hapur për të gjithë personat juridikë që synojnë të bëhen pjesëmarrës në sistemet e shlyerjes së titujve të vëna në

funksion nga DQT.

- b) Procedurat për zbatimin e masave disiplinore ndaj pjesëmarrësve ekzistues që nuk plotësojnë kriteret e pjesëmarrjes.

Neni 19 **Informacion mbi Transparencën**

1. Aplikimi për licencim duhet të përfshijë dokumentet dhe informacionet mbi politikën e çmimeve dhe tarifave të DQT në lidhje me shërbimet në përputhje me nenin 221 të Ligjit. Informacioni duhet të përfshijë në veçanti çmimet dhe tarifatat për çdo shërbim kryesor që ofrohet nga DQT dhe çdo zbritje nga tarifatat, përfshirë kushtet për zbritjet/skontot.
2. Aplikuesi për DQT depoziton pranë Autoritetit përshkrimin e metodave që përdoren për të zbuluar informacionin përkatës në përputhje me nenin 221 të Ligjit.
3. Aplikimi për licencim duhet të përfshijë informacion për përmbushjen e kriterëve për të llogaritur veçmas kostot dhe të ardhurat e DQT në përputhje me nenin 221 të Ligjit.

Nënseksioni 5 – Kriteret për shërbimet që ofron DQT

Neni 20 **Informacionet mbi proceset e regjistrimit në llogari**

Aplikimi për licencim duhet të përfshijë informacione mbi proceset lidhur me mënyrën e regjistrimit të titujve në llogari.

Neni 21 **Informacion për datat e synuara të shlyerjes dhe masat për parandalimin e mosshlyerjes**

Aplikimi për licencim duhet të përfshijë informacion lidhur me sa më poshtë:

- a) Procedurat dhe masat për parandalimin e rasteve të mosshlyerjes në përputhje me nenin 218 të Ligjit;
- b) Masat për trajtimin e rasteve të mosshlyerjes në përputhje me nenin 219 të Ligjit.

Neni 22 **Informacion mbi integritetin e emetimit**

Aplikimi për licencim duhet të përfshijë informacion në lidhje me rregullat dhe procedurat e DQT për të siguruar integritetin e emetimeve të titujve të referuara në nenin 45, të kësaj rregulloreje.

Neni 23

Informacion për mbrojtjen e titujve të pjesëmarrësve dhe klientëve të tyre

Aplikimi për licencim duhet të përfshijë informacion për masat për të mbrojtur titujt e pjesëmarrësve të DQT-së dhe atyre të klientëve të tyre në përputhje me nenin 46 të kësaj rregulloreje, duke përfshirë sa më poshtë:

- a) Rregullat dhe procedurat për të minimizuar dhe administruar rreziqet që lidhen me ruajtjen e titujve;
- b) Një përshkrim të detajuar të niveleve të ndryshme të segregimit që ofron DQT, si dhe përshkrimin e kostove që lidhen me secilin nivel;
- c) Procedurën për marrjen e miratimit sipas rastit të parashikuar në nenin 46, pika 7, të kësaj rregulloreje.

Neni 24

Informacion për finalizimin e shlyerjes

Aplikimi për licencim duhet të përmbajë informacion në lidhje me rregullat për finalizimin e shlyerjes në përputhje me nenin 49 të kësaj rregulloreje.

Neni 25

Informacion për shlyerjen e cash-it

1. Aplikimi për licencim përfshin procedurat për shlyerjen e “cash-it” për çdo sistem të shlyerjes së titujve që operon DQT në përputhje me nenin 48 të kësaj rregulloreje.
2. DQT duhet të japë informacion nëse shlyerja e “cash-it” kryhet në përputhje me nenin 48 të kësaj rregulloreje.

Neni 26

Informacion mbi rregullat dhe procedurat për raste e mospërmbushjes nga ana e pjesëmarrësve

Aplikimi për licencim duhet të përfshijë rregullat dhe procedurat për të menaxhuar rastet e mospërmbushjes nga një ose më shumë prej pjesëmarrësve të DQT-së në përputhje me nenin 222 të Ligjit dhe nenit 49 të kësaj rregulloreje.

Nëseksioni 6 – Kriteret prudenciale

Neni 27

Informacion mbi rrezikun ligjor

1. Aplikimi për licencim duhet të përfshijë informacion të plotë për të siguruar se rregullat, procedurat dhe kontratat që përdor DQT janë të qarta, të kuptueshme dhe të zbatueshme në përputhje me nenin 51 të kësaj rregulloreje.
2. Kur DQT synon të operojë aktivitetin e saj në juridiksione të ndryshme, duhet t'i japë Autoritetit informacione në lidhje me masat e marra për të identifikuar dhe zbutur rreziqet

që rrjedhin nga konflikti i mundshëm i juridiksioneve në përputhje me nenin 51, të kësaj rregulloreje. Ky informacion përfshin çdo vlerësim ligjor mbi të cilin bazohen këto masa.

Neni 28

Informacion mbi rreziqet e përgjithshme të veprimtarisë

1. Aplikimi për licencim duhet të përfshijë një përshkrim të sistemeve për menaxhimin dhe kontrollin e rrezikut, si dhe mjetet e TI-së të vëna në zbatim nga DQT për të menaxhuar rreziqet e veprimtarisë në përputhje me nenin 52 të kësaj rregulloreje.
2. DQT duhet të informojë dhe t'i japë informacionin përkatës Autoritetit në çdo rast kur merr një vlerësim rrisht nga një palë e tretë.

Neni 29

Informacion mbi rrezikun operacional

1. Aplikimi për licencim duhet të përfshijë informacionin që tregon se DQT është në përputhje me kriteret për menaxhimin e rrezikut operacional në përputhje me nenin 53, të kësaj rregulloreje.
2. Aplikimi për licencim duhet të përmbajë gjithashtu listën e shërbimeve që jepen nga një palë e tretë në përputhje me nenin 43, të kësaj rregulloreje duke përfshirë informacionin si më poshtë:
 - a) Kopje të marrëveshjeve të delegimit të shërbimeve;
 - b) Metodatat e përdorura për të monitoruar delegimin e shërbimeve.

Neni 30

Informacion mbi politikën e investimeve

Aplikimi për licencim duhet të përfshijë politikën e investimit në përputhje me nenin 54 të kësaj rregulloreje.

Neni 31

Informacion mbi kërkesat për kapital

Aplikimi për licencim duhet të përfshijë informacion në lidhje me kërkesat për kapitalin e DQT si më poshtë:

- a) Informacion që tregon se kapitali i DQT, përfshirë fitimet e pashpërndara ose rezervat, plotëson kriteret e nenit 55 të kësaj rregulloreje;
- b) Planin sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 2 të kësaj rregulloreje, çdo përditësim të këtij plani, si dhe vendimin e Këshillit Mbikëqyrës/Këshillit Administrimit të aplikantit për miratimin e tij.

Neni 32

Informacion mbi rregullat e aksesit

Aplikimi për licencim duhet të përfshijë një përshkrim të procedurave për trajtimin e kërkesave për akses, nga persona juridikë që synojnë të bëhen pjesëmarrës në përputhje me

nenin 220 të Ligjit, si dhe nga infrastrukturat e tjera të tregut në përputhje me nenin 223 të Ligjit.

Neni 33 **Kërkesë për informacion shtesë**

Autoriteti mund të kërkojë nga aplikuesi për Depozitar Qëndror i Titujve çdo informacion shtesë të nevojshëm për të vlerësuar nëse, në momentin e dhënies së licencës DQT është në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

KREU III **MBIKËQYRJA E DQT**

Neni 34 **Shqyrtimi dhe vlerësimi**

1. Autoriteti shqyrton, të paktën një herë në vit, marrëveshjet, strategjitë, proceset dhe mekanizmat që zbatohen nga DQT në lidhje me përputhshmërinë me këtë rregullore, si dhe do të vlerësojë rreziqet ndaj të cilave DQT ekspozohet ose mund të ekspozohet.
2. Autoriteti i kërkon DQT të paraqesë një plan të përshtatshëm për vijimësinë e biznesit.
3. DQT duhet të hartojë dhe të ketë planin për vazhdimësinë e biznesit duke mbajtur në konsideratë madhësinë, rëndësinë sistemike, natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarive të saj.
4. Autoriteti verifikon planin e vijimësisë së biznesit të DQT duke pasur parasysh madhësinë, rëndësinë sistemike, natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarive të DQT përkatëse. Shqyrtimi dhe vlerësimi do të përditësohen të paktën një herë në vit.

Neni 35 **Informacioni për Autoritetin**

1. Për qëllim të këtij kapitulli, një “periudhë shqyrtimi” do të përfshijë periudhën ndërmjet licencimit fillestar që i është dhënë një DQT-je në përputhje me nenin 6 të kësaj rregulloreje dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të parë të referuar në nenin 34 të kësaj rregulloreje.
2. Për qëllimet e shqyrtimit dhe vlerësimit të referuar në nenin 34 të kësaj rregulloreje, DQT duhet të japë informacionin e mëposhtëm:
 - a) Informacionin e referuar në nenin 36 të kësaj rregulloreje;
 - b) Një raport mbi veprimtaritë e DQT dhe ndryshimet thelbësore sipas nenin 5, pika 4, të kësaj rregulloreje të bëra gjatë periudhës së shqyrtimit dhe të gjitha dokumentet përkatëse;
 - c) Çdo informacion shtesë të kërkuar nga Autoriteti, i cili është i nevojshëm për vlerësimin e përputhshmërisë së DQT dhe veprimtarive të saj me ligjin dhe këtë rregullore gjatë periudhës së shqyrtimit.
3. Raporti i referuar në nënpikën b) të pikës 2, të këtij neni përfshin deklaratën e DQT për përputhshmërinë me dispozitat e Ligjit dhe kësaj rregulloreje gjatë periudhës së shqyrtimit.

4. Informacioni i parashikuar në këtë nen duhet të jetë sipas Shtojcës III të kësaj rregulloreje.

Neni 36

Informacion periodik për periudhën e shqyrtimit

Për çdo periudhë shqyrtimi, DQT duhet t'i japë Autoritetit informacionin e mëposhtëm:

- a) Një set të plotë të pasqyrave financiare më të fundit të audituara;
- b) Një version të përmbledhur të pasqyrave financiare të ndërmjetme më të fundit;
- c) Çdo vendim të Këshillit Mbikëqyrës/Këshillit Administrues pas këshillës nga Komiteti i përdoruesve, si dhe çdo vendim kur ky organ ka vendosur të mos ndjekë këshillën e Komitetit të përdoruesve;
- d) Informacion mbi çdo procedurë civile, administrative ose çdo procedurë tjetër gjyqësore ose jashtëgjyqësore ende në proces që përfshin DQT, veçanërisht në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me taksat dhe paaftësinë pagueuse (falimentimin), ose çështjet që mund të shkaktojnë kosto financiare ose reputacioni për DQT;
- e) Informacion mbi çdo procedurë civile, administrative ose çdo procedurë tjetër gjyqësore ose jashtëgjyqësore ende në proces që përfshin një anëtar të Këshillit Mbikëqyrës/Këshillit Administrues ose një anëtar të menaxhimit të lartë që mund të ketë ndikim negativ në DQT;
- f) Çdo vendim përfundimtar që rezulton nga procedurat e referuara në pikat (d) dhe (e);
- g) Një kopje të rezultateve të testeve të stresit të vazhdimësisë së biznesit ose ushtrimeve të ngjashme të kryera gjatë periudhës së shqyrtimit;
- h) Një raport mbi incidentet operationale që kanë ndodhur gjatë periudhës së shqyrtimit dhe kanë ndikuar në ofrimin e qetë të çdo shërbimi bazë, masat e marra për adresimin e tyre dhe rezultatin e tyre;
- i) Një raport mbi performancën e sistemit të shlyerjes së titujve, duke përfshirë një vlerësim të disponueshmërisë së sistemit gjatë periudhës së shqyrtimit, të matur çdo ditë si përqindje e kohës që sistemi është funksional dhe funksionon sipas parametrave të dakordësuar;
- j) Një përmbledhje të llojeve të ndërhyrjes manuale të realizuara nga DQT;
- k) Shkaqet dhe informacion në lidhje me identifikimin e operacioneve kritike të DQT, çdo ndryshim thelbësor në planin e saj të vijimësisë së biznesit, rezultatet e skenarëve të stresit, dhe mjetet për vijimësinë e biznesit;
- l) Informacione për çdo ankesë zyrtare të marrë nga DQT gjatë periudhës së shqyrtimit, duke përfshirë natyrën e ankesave, mënyrën e trajtimit të ankesës, duke përfshirë rezultatin e ankesës dhe datën kur ka përfunduar trajtimi i ankesës;
- m) Informacione në lidhje me rastet kur DQT i ka refuzuar aksesin në shërbimet e saj çfarëdo pjesëmarrësi ekzistues ose të mundshëm, çdo emetuesi, një DQT-je tjetër ose një infrastrukture tjetër tregu në përputhje me nenet 220, pika 3 dhe 223, pika 3 të Ligjit;
- n) Informacione në lidhje me të gjitha rastet e konflikteve të interesit të identifikuar që janë materializuar gjatë periudhës së shqyrtimit, duke përfshirë përshkrimin se si ato janë trajtuar;
- o) Informacione në lidhje me kontrollet e brendshme dhe auditimet e kryera nga DQT gjatë

periudhës së shqyrtimit;

- p) Informacione në lidhje me çdo shkelje të identifikuar të Ligjit dhe kësaj rregulloreje, duke përfshirë ato të identifikuara nëpërmjet kanalit të raportimit të referuar në nenin 40, pika 5, të kësaj rregulloreje;
- q) Strategjinë e përgjithshme të biznesit të DQT-së që mbulon një periudhë prej të paktën tre vitesh pas rishikimit dhe vlerësimit të fundit dhe një plan biznesi të detajuar për shërbimet e ofruara nga DQT që mbulon të paktën një periudhë prej një viti pas shqyrtimit dhe vlerësimit të fundit.

Neni 37 **Informacione të tjera**

Dokumentet e depozituara në Autoritet nga DQT në përputhje me nenin 35 të kësaj rregulloreje duhet të tregojnë sa vijon:

- a) Nëse dokumenti po depozitohet për herë të parë apo është një dokument që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së shqyrtimit;
- b) Llojin e dokumentit;
- c) Evidentimin e ndryshimeve gjatë periudhës së shqyrtimit dhe çdo shpjegim shtesë në lidhje me ndryshimet e paraqitura gjatë kësaj periudhe.

KREU IV **KËRKESAT PËR DQT-të**

Seksioni 1 **Kërkesat Organizative**

Neni 38 **Dispozita të përgjithshme**

1. DQT duhet të ketë rregullime të plota drejtuese, të cilat përfshijnë një strukturë të qartë organizative me linja përgjegjësie të përcaktuara mirë, transparente dhe të qëndrueshme, procese efikase për të identifikuar, menaxhuar, monitoruar dhe raportuar rreziqet ndaj të cilave ekspozohet ose mund të ekspozohet, si dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm, duke përfshirë procedurat e plota administrative dhe kontabël.
2. DQT duhet të miratojë politika dhe procedura të cilat janë mjaftueshëm efikase për të siguruar pajtueshmërinë me Ligjin dhe këtë rregullore, duke përfshirë pajtueshmërinë e drejtuesve dhe punonjësve të saj me të gjitha dispozitat e kësaj rregulloreje.
3. DQT mban dhe zbaton procedura efikase organizative dhe administrative, në formë të shkruar, për të identifikuar dhe menaxhuar çdo konflikt të mundshëm interesi ndërmjet saj, duke përfshirë menaxherët, punonjësit, anëtarët e organit drejtues ose çdo person të lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me ta, dhe pjesëmarrësve të saj apo klientëve të tyre. Ajo do të ketë dhe do të zbatojë procedura të duhura zgjidhjeje kur ndodhin konflikte të mundshme interesi.
4. DQT do të vërë në dispozicion të publikut masat e saj të qeverisjes dhe rregullat që

rregullojnë veprimtarinë e saj.

5. DQT duhet të ketë procedura të përshtatshme që punonjësit e saj të raportojnë shkeljet e brendshme të mundshme të kësaj rregulloreje nëpërmjet një kanali të caktuar.
6. DQT duhet t'i nënshtrohet auditimeve të rregullta dhe të pavarura. Rezultatet e këtyre auditimeve do t'i komunikohen organit drejtues dhe do t'i vihen në dispozicion Autoritetit dhe, sipas rastit, duke marrë parasysh konfliktet e mundshme të interesit ndërmjet anëtarëve të Komitetit të përdoruesve dhe DQT-së.
7. DQT si dhe audituesit e saj të pavarur, do të informojnë, pa vonesë, Autoritetin për çdo ndryshim thelbësor që ndikon në pajtueshmërinë me kushtet për autorizim.
8. DQT i vë në dispozicion Autoritetit dhe audituesit, sipas kërkesës, procesverbalet e mbledhjeve të organit drejtues.

Neni 39

Menaxhimi i lartë, organi drejtues, Këshilli Mbikëqyrës/Këshilli i Administrimit dhe aksionarët

1. Menaxhimi i lartë i një DQT-je duhet të ketë reputacion dhe përvojë mjaft të mirë për të siguruar menaxhimin e plotë dhe të kujdesshëm të DQT-së.
2. DQT duhet të ketë një organ drejtues, nga i cili të paktën një e treta, por jo më pak se dy prej anëtarëve të saj të jenë të pavarur.
3. Organi drejtues përbëhet nga anëtarë të përshtatshëm me reputacion mjaft të mirë dhe që mbulojnë fusha të ndryshme njohurish, përvojë dhe njohuri për institucionet e tregut.
4. Këshilli Mbikëqyrës/Këshilli i Administrimit përbëhet nga anëtarë të përshtatshëm me reputacion mjaft të mirë me një diversifikim të përshtatshëm aftësish, eksperience dhe njohurish të njësish ekonomike dhe tregut. Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës të një DQT-je mund të jetë një person që është pjesë e organit drejtues në një njësi tjetër ose është palë e enteve të grupit të DQT-së, përveç rasteve kur ai mund t'i kushtojë kohë të mjaftueshme për të kryer detyrën e tij si Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës dhe si anëtar i Këshillit Drejtues të një subjekti tjetër ose bën pjesë në grupin e enteve të DQT-së.
5. DQT duhet të përcaktojë qartë rolin dhe përgjegjësitë e organit drejtues. DQT do të vërë në dispozicion të Autoritetit dhe audituesit, procesverbalet e mbledhjeve të organit drejtues sipas kërkesës.
6. Aksionarët e DQT-së dhe personat, të cilët janë në një pozicion të tillë që mund të ushtrojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, kontroll mbi menaxhimin e DQT-ve duhet të jenë të përshtatshëm për të siguruar një menaxhim të plotë dhe të kujdesshëm të DQT-së.
7. DQT-ja:
 - a) Duhet të vërë në dispozicion të Autoritetit dhe të bëjë publike informacione në lidhje me pronësinë e DQT-së dhe në veçanti, identitetin dhe shkallën e interesave të çdo pale që mund të ushtrojë kontroll mbi funksionimin e DQT-së;
 - b) Do të informojë dhe do të kërkojë miratimin e Autoritetit për çdo vendim për transferimin e të drejtave të pronësisë që sjell ndryshim në identitetin e personave që ushtrojnë kontroll mbi funksionimin e DQT-së. Pas marrjes së miratimit nga Autoriteti, DQT do të bëjë publike kalimin e të drejtave të pronësisë;
 - c) Çdo person fizik ose juridik informon pa vonesë DQT-në dhe Autoritetin për një vendim

për të përvetësuar ose disponuar të drejtat e tij të pronësisë që sjellin një ndryshim në identitetin e personave që ushtrojnë kontroll mbi funksionimin e DQT-së.

8. Autoriteti, brenda 60 ditësh pune nga marrja e informacionit të referuar në pikën 7, të këtij neni, merr vendim për ndryshimet e propozuara në kontrollin e DQT .
9. Autoriteti refuzon miratimin e ndryshimeve të propozuara në kontrollin e DQT-së kur ka arsye objektive dhe të dukshme për të besuar se ato do të përbëjnë një kërcënim për menaxhimin e plotë dhe të kujdesshëm të DQT-së ose për aftësinë e DQT-së për të qenë në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe kësaj rregullore.
10. Subjektet sipas kësaj rregulloreje kanë detyrimin të garantojnë përmbushjen e vazhdueshme të kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga individët që mbajnë pozicionet përkatëse. Vlerësimi i këtyre kriterëve duhet të kryhet rregullisht, të paktën një herë në vit, si dhe në çdo rast kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në rrethanat që mund të ndikojnë në profilin e individit. Subjektet depozitojnë në Autoritet çdo vit, brenda muajit mars të vitit pasardhës vetëdeklarimet përkatëse të çdo individit mbi vijueshmërinë e përmbushjes së kriterëve.

Neni 40 **Komiteti i përdoruesve**

1. DQT krijon Komitetet e përdoruesve për çdo sistem shlyerjeje të titujve që operon, të cilët përbëhen nga përfaqësues të emetuesve dhe të pjesëmarrësve të këtyre sistemeve. Këshillat/sugjerimet e Komitetit të përdoruesve janë të pavarura nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë i organeve drejtuese të DQT.
2. DQT përcakton në mënyrë jo diskriminuese mandatin e secilit Komitet të krijuar të përdoruesve, rregullat e nevojshme të qeverisjes për të siguruar pavarësinë dhe procedurat e tij operacionale, si edhe kriteret e pranimin dhe mekanizmat e zgjedhjes së anëtarëve të Komitetit të përdoruesve. Rregullat e qeverisjes bëhen publike dhe sigurojnë që Komiteti i përdoruesve i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë organeve drejtuese si dhe mban takime të rregullta.
3. Komitetet e përdoruesve këshillojnë organet drejtuese për rregullat kryesore që ndikojnë tek anëtarët e tyre, duke përfshirë kriteret për pranimin e emetuesve ose pjesëmarrësve në sistemet e tyre respektive të shlyerjes së titujve dhe në nivelin e shërbimit.
4. Komitetet e përdoruesve mund të japin një opinion jo detyrues tek organet drejtuese, i cili përmban arsyetime të detajuara në lidhje me strukturën e çmimeve të DQT.
5. Pa paragjykuar të drejtën e autoriteteve kompetente për t'u informuar në mënyrën e duhur, anëtarët e Komitetit të përdoruesve duhet t'i nënshtrohen konfidencialitetit. Nëse Kryetari i Komitetit të përdoruesve përcakton se një anëtar ka një konflikt interesi aktual ose të mundshëm në lidhje me një çështje të veçantë, atëherë ai anëtar nuk do të lejohet të votojë për atë çështje.
6. DQT i njofton menjëherë Autoritetin kompetent dhe Komitetit të përdoruesve, çdo vendim në të cilin organi drejtues vendos të mos ndjekë këshillat e komitetit të përdoruesve. Komiteti i përdoruesve mund të informojë Autoritetin kompetent mbi çdo fushë në të cilën konsideron se këshillat e tij nuk janë ndjekur.

Neni 41

Ruajtja e të dhënave

1. DQT duhet të ruajë, për një periudhë prej të paktën 10 vitesh, të gjitha të dhënat e saj mbi shërbimet dhe veprimtaritë, duke përfshirë shërbimet ndihmëse të referuara në nenin 212 të Ligjit, në mënyrë që t'i mundësojë Autoritetit monitorimin e përputhshmërisë me kriteret e kësaj rregulloreje.
2. DQT vendos në dispozicion të Autoritetit, me kërkesë të tij, të dhënat e referuara në pikën 1, të këtij neni..
3. Informacioni i parashikuar në këtë nen do të jepet sipas Shtojcës II të kësaj Rregulloreje.

Neni 42

Delegimi i shërbimeve

1. DQT mund të delegojë tek një palë e tretë shërbime ose veprimtari të caktuara, por në çdo rast ajo mbetet plotësisht përgjegjëse për përmbushjen e të gjitha detyrimeve sipas kësaj rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi.
2. DQT duhet të veprojë në çdo kohë në përputhje me sa më poshtë:
 - a) Kontraktimi i jashtëm nuk rezulton në delegimin e përgjegjësisë së saj;
 - b) Marrëdhëniet dhe detyrimet e DQT-së-ndaj pjesëmarrësve ose emetuesve të saj nuk ndryshojnë;
 - c) Kushtet e licencimit e DQT-së nuk ndryshojnë;
 - d) Marrëdhëniet dhe detyrimet e DQT-së ndaj pjesëmarrësve ose emetuesve të saj nuk ndryshojnë;
 - e) Kontraktimi i jashtëm nuk pengon ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse, duke përfshirë aksesin në vend për të marrë çdo informacion përkatës të nevojshëm për përmbushjen e këtyre funksioneve;
 - f) Kontraktimi i jashtëm nuk rezulton në privimin e DQT-së nga sistemet dhe kontrollet e nevojshme për të menaxhuar rreziqet me të cilat përballet;
 - g) DQT ruan ekspertizën dhe burimet e nevojshme për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara, përshtatshmërinë organizative dhe të kapitalit të ofruesit të shërbimit, për mbikëqyrjen efikase të shërbimeve të kontraktuara dhe për menaxhimin e risqeve që lidhen me kontraktimin në mënyrë të vazhdueshme;
 - h) DQT ka akses të drejtpërdrejtë në informacionet përkatëse të shërbimeve të jashtme;
 - i) Ofruesi i shërbimeve bashkëpunon me Autoritetin në lidhje me veprimtaritë e kontraktuara;
 - j) DQT siguron se ofruesi i shërbimit përmbush standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave dhe ruajtjen e konfidencialitetit. DQT është përgjegjëse për të siguruar që ato standarde të përcaktohen në një kontratë ndërmjet palëve dhe se ato standarde janë ruajtur.
3. DQT përcakton me një marrëveshje me shkrim të drejtat dhe detyrimet e saj dhe ato të ofruesit të shërbimit. Marrëveshja e kontraktimit duhet t'i lejojë DQT-së t'i japë fund marrëveshjes. Marrëveshja e kontraktimit duhet të parashikojë edhe detyrimin e

nënkontraktorit/kontraktorit për të raportuar pranë Autoritetit, me kërkesë të tij, si dhe të drejtën e Autoritetit për t'i mbikëqyrur, në varësi të rëndësisë që paraqet për sigurinë e veprimtarisë së DQT shërbimi i kontraktuar/nënkontraktuar.

4. DQT dhe ofruesi i shërbimeve vënë në dispozicion Autoritetit, sipas kërkesës, të gjitha informacionet e nevojshme për t'i mundësuar atij të vlerësojë përputhshmërinë e veprimtarive të kontraktuara me kriteret e kësaj rregulloreje.
5. DQT për të marrë miratimin e parashikuar në nenin 8 të rregullores paraqet një kërkesë me shkrim pranë Autoritetit të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - i. Vendimin e Bankës së Shqipërisë për miratimin e marrëveshjeve me të tretët (outsourcing) ;
 - ii. Kontratat/marrëveshjet përkatëse për shërbimin e nënkontraktuar/kontraktuar;
 - iii. Vendimin e organit drejtues për lidhjen e marrëveshjeve me të tretët (outsourcing) për shërbimet e DQT;
 - iv. Analiza/vlerësime dhe dokumentacione të organeve drejtuese të DQT, të cilat sigurojnë se cilësia e shërbimeve dhe vijimësia e veprimtarisë nuk cenohen apo komprometohen nga transferimi i aktiviteteve, se ofruesi i shërbimit ka reputacion, eksperiencën e duhur, si dhe një situatë financiare të qëndrueshme, njohjen dhe kontrollin mbi rreziqet që mund të rrjedhin nga transferimi i aktiviteteve.

Neni 43

Shërbimet që ofrohen nga palë të tjera të ndryshme nga DQT-të

Të gjitha shërbimet që ofrohen nga palë të tjera të ndryshme nga DQT-të, duhet të respektojnë kërkesat e nenit 42 të kësaj rregulloreje.

Seksioni 2

Kriteret për shërbimet e DQT-së

Neni 44

Dispozitat e përgjithshme

Për çdo sistem të shlyerjes së titujve që operon, DQT duhet të ketë rregulla dhe procedura të përshtatshme, duke përfshirë praktika dhe kontrole të plota kontabël, për të ndihmuar në sigurimin e integritetit të emetimeve të titujve dhe për të reduktuar dhe menaxhuar rreziqet që lidhen me ruajtjen dhe shlyerjen e transaksioneve në tituj.

Neni 45

Integriteti i emimit

1. DQT duhet të marrë masat e duhura rakorduese për të verifikuar që numri i titujve që përbëjnë një emetim titujsh ose pjesë të një emetimi të titujve të paraqitur në DQT të jetë i barabartë me shumën e titujve të regjistruara në llogaritë e titujve të pjesëmarrësve të sistemit të shlyerjes së titujve që operon DQT dhe aty ku është e përshtatshme, në llogaritë e pronarëve që mbahen nga DQT-ja. Masa të tilla rakordimi duhet të kryhen të paktën një herë në ditë.

2. Kur është e përshtatshme dhe nëse shoqëri të tjera përfshihen në procesin e rakordimit për një emetim të caktuar të titujve, si emetuesi ose DQT të tjera, DQT dhe çdo subjekt i tillë duhet të kenë bashkëpunimin e duhur dhe të marrin masa për shkëmbimin e informacionit në mënyrë që të ruhet integriteti i emetimit.
3. Overdraft-et e titujve, balancat debitoare ose krijimi i titujve nuk lejohen në një sistem shlyerjeje të titujve, i cili operohet nga një DQT.

Neni 46

Mbrojtja e titujve të pjesëmarrësve dhe klientëve të tyre

1. Për çdo sistem të shlyerjes së titujve që operon, DQT duhet të mbajë të dhëna dhe llogari që do t'i mundësojnë, në çdo kohë dhe pa vonesë, të ndajë në llogaritë me DQT-në, titujt e një pjesëmarrësi nga ato të çfarëdo pjesëmarrësi tjetër dhe nëse është e zbatueshme, nga asetet e vetë DQT-së.
2. DQT duhet të mbajë të dhëna dhe llogari që i mundësojnë çdo pjesëmarrësi të veçojë titujt e pjesëmarrësit nga ato të klientëve të pjesëmarrësit.
3. DQT do të mbajë regjistrime dhe llogari që i mundësojnë çdo pjesëmarrësi të mbajë në një llogari titujsh titujt që u përkasin klientëve të ndryshëm të atij pjesëmarrësi (“ndarja e klientëve omnibus”)
4. DQT duhet të mbajë të dhëna dhe llogari që i mundësojnë një pjesëmarrësi të veçojë titujt të cilitdo prej klientëve të pjesëmarrësit, nëse dhe siç kërkohet nga pjesëmarrësi (“ndarja e klientëve individualë”).
5. Pjesëmarrësi duhet t’u ofrojë klientëve të tij të paktën zgjedhjen midis ndarjes së “klientit omnibus” dhe ndarjes së klientit individual dhe t’i informojë ata për kostot dhe rreziqet që lidhen me secilin opsion.
6. DQT dhe pjesëmarrësit e tyre duhet të bëjnë publike nivelet e mbrojtjes dhe kostot që lidhen me nivelet e ndryshme të ndarjes që ato ofrojnë dhe duhet t’i ofrojnë ato shërbime me kushte të arsyeshme tregtare. Detajet e niveleve të ndryshme të ndarjes duhet të përfshijnë një përshkrim të implikimeve ligjore kryesore të niveleve përkatëse të ndarjes të ofruara, duke përfshirë informacionin mbi ligjin e zbatueshëm për falimentimin në juridiksionet përkatëse.
7. DQT nuk duhet përdorë për asnjë qëllim tituj që nuk i përkasin. Megjithatë DQT mund të përdorë tituj të një pjesëmarrësi kur ka marrë miratimin e shprehur paraprakisht të atij pjesëmarrësi. DQT do t’u kërkojë pjesëmarrësve të saj të marrin çfarëdo miratimi paraprak të nevojshëm nga klientët e tyre.

Neni 47

Përfundimi i shlyerjes

1. DQT duhet të sigurojë që sistemi i shlyerjes së titujve që ajo operon ofron mbrojtje të përshtatshme për pjesëmarrësit.
2. DQT duhet të sigurojë që çdo sistem i shlyerjes së titujve që operon të përcaktojë momentet e regjistrimit dhe të parevokueshmërisë së urdhrave të transferimit në atë sistem të shlyerjes së titujve.
3. DQT duhet të bëjë publike rregullat që rregullojnë përfundimin e transfertave të titujve dhe

parave në një sistem të shlyerjes së titujve.

4. DQT duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të siguruar që, në përputhje me rregullat e referuara në pikën 3, të këtij neni, përfundimi i transfertave të titujve dhe parave “cash” të referuara në pikën 3, të këtij neni arrihet ose në kohë reale ose brenda ditës, dhe në çdo rast jo më vonë se në fund të ditës së punës të datës faktike të shlyerjes.
5. Kur DQT ofron shërbimet e referuara në nenin 48, pika 2 të kësaj rregulloreje, ajo siguron që të ardhurat në para të shlyerjeve të titujve të jenë të disponueshme për marrësit për t'i përdorur jo më vonë se deri në fund të ditës së punës të datës së synuar të shlyerjes.
6. Të gjitha transaksionet e titujve kundrejt parave “cash” ndërmjet pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë në një sistem të shlyerjes së titujve që operohet nga DQT-ja dhe shlyhet në atë sistem të shlyerjes së titujve do të shlyhen me një transferim të fondeve në mënyrë që dorëzimi i titujve të ndodhë vetëm nëse ndodh transferimi korrespondues i parave *cash* dhe anasjelltas. (Delivery versus Payment)

Neni 48

Shlyerja e cash-it

1. Për transaksionet e shprehura në monedhën e vendit ku kryhet shlyerja, DQT-ja do të shlyejë pagesat “cash” të sistemit të saj të shlyerjes së titujve nëpërmjet llogarive të hapura në një bankë qendrore të emetimit të monedhës përkatëse, kur është praktike dhe e disponueshme.
2. Kur nuk është praktike dhe e disponueshme për të shlyer në llogaritë e bankës qendrore, siç parashikohet në pikën 1, të këtij neni, DQT mund të ofrojë shlyerjen e pagesave në para për të gjitha ose një pjesë të sistemeve të saj të shlyerjes së titujve nëpërmjet llogarive të hapura në një bankë ose nëpërmjet llogarive të veta.
3. DQT-ja duhet të sigurojë që çdo informacion i dhënë pjesëmarrësve të tregut në lidhje me risqet dhe kostot që lidhen me shlyerjen në llogaritë e bankës ose nëpërmjet llogarive të veta është i qartë, i drejtë dhe jo keqinformues. DQT duhet të vërë në dispozicion informacion të mjaftueshëm për klientët ose klientët e mundshëm për t'i lejuar ata të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet dhe kostot që lidhen me shlyerjen në llogaritë e bankave ose nëpërmjet llogarive të veta dhe duhet të ofrojë një informacion të tillë sipas kërkesës.

Neni 49

Rregullat dhe procedurat në rast mospërmbushjeje nga ana e pjesëmarrësve

1. Për çdo sistem të shlyerjes së titujve që operon, DQT-ja do të ketë rregulla dhe procedura efikase dhe të përcaktuara qartë për të menaxhuar mospërmbushjen nga ana e një ose më shumë prej pjesëmarrësve të saj, duke siguruar që DQT të mund të ndërmarrë veprime në kohë për të kontrolluar humbjet dhe presionet e likuiditetit dhe të vazhdojë të përmbushë detyrimet e saj.
2. DQT vë në dispozicion të publikut rregullat dhe procedurat përkatëse të saj në rast mospërmbushjeje.
3. DQT duhet të ndërmarrë me pjesëmarrësit e saj dhe palët e tjera përkatëse të interesuara testimin dhe rishikimin periodik të procedurave në rast mospërmbushjeje për të siguruar se ato janë praktike dhe efikase.
4. Për secilin sistem të shlyerjes së titujve që operon, Depozitari Qendror i Titujve krijon një sistem, që monitoron rastet e mosshlyerjes së transaksioneve me instrumente financiare.

Depozitari Qendror i Titujve i raporton rregullisht Autoritetit për numrin dhe detajet e rasteve të mosshlyerjes dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm, përfshirë masat e parashikuara nga Depozitari Qendror i Titujve dhe pjesëmarrësit e tij për të përmirësuar efikasitetin e shlyerjeve. Këto raporte bëhen publike në baza vjetore nga Depozitari Qendror i Titujve në formë të përmbledhur dhe anonime.

5. Për çdo sistem të shlyerjes së titujve që operon, Depozitari Qendror i Titujve miraton procedura që synojnë të sigurojnë shlyerjen e transaksioneve me instrumente financiare, të cilat nuk janë shlyer në datën e synuar të shlyerjes. Këto procedura parashikojnë edhe një mekanizëm ndëshkimor, i cili shërben si frenues efektiv për pjesëmarrësit që shkaktojnë raste mosshlyerjeje.
6. Mekanizmi ndëshkimor i parashikuar në pikën 5 të këtij neni si dhe nenin 219 të Ligjit duhet të përfshijë edhe penalitete në “cash” për pjesëmarrësit që shkaktojnë dështimin e shlyerjes. Këto penalitete duhet të përlllogariten mbi bazë ditore për çdo ditë pune që transaksioni ka dështuar të shlyhet pas datës së synuar deri në fund të procesit “buy-in”, por jo më gjatë se afati aktual i shlyerjes. Penalitetet në “cash” nuk duhet të konfigurohen si një burim të ardhurash për DQT. Pavarësisht mekanizmit të penaltetit të parashikuar në këtë nen dhe të drejtës dypalëshe për anulim transaksioni, kur një pjesëmarrës nuk i dorëzon palës tjetër instrumentin financiar brenda 4 ditësh pune pas datës së synuar, atëherë mund të iniciohet procesi “buy-in”, ku këto instrumente duhet të jenë në dispozicion për shlyerje dhe të transferohen tek pjesëmarrësi përfitues i tyre brenda një periudhe kohore të përshtatshme.
7. Pavarësisht parashikimit të pikës 6 të këtij neni, në rast se instrumentet financiare janë jo likuide duhet që periudha përpara fillimit të procesit “buy-in” të rritet deri në një maksimum prej 7 ditësh pune nga data e synuar, kur duhej të ishte shlyer transaksioni.

Seksioni 3 Kriteret prudenciale

Neni 50 Kriteret e përgjithshme

DQT duhet të ketë një kuadër të plotë të miratuar për menaxhimin e riskut për të menaxhuar në mënyrë gjithëpërfshirëse risqet ligjore, të biznesit, operacionale dhe risqe të tjera të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta, duke përfshirë masat për të zbutur mashtrimin dhe neglizhencën.

Neni 51 Risqet ligjore

1. Për qëllim të licencimit dhe mbikëqyrjes së saj, si dhe për informimin e klientëve të saj, DQT duhet të ketë rregulla, procedura dhe kontrata të qarta dhe të kuptueshme për të gjitha sistemet e shlyerjes së titujve që ajo operon dhe të gjitha shërbimet e tjera që ajo ofron.
2. DQT duhet të hartojë rregullat, procedurat dhe kontratat e saj në mënyrë që ato të jenë të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë edhe rastin e mospërbushjes së një pjesëmarrësi.
3. DQT që ushtron veprimtarinë e biznesit në juridiksione të ndryshme do të ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të identifikuar dhe zbutur risqet që rrjedhin nga konfliktet e

mundshme të ligjit në të gjitha juridiksionet.

Neni 52

Risku i përgjithshëm i biznesit

DQT duhet të ketë sisteme të përshtatshme për menaxhim dhe kontroll, si dhe mjete të TI-së për të identifikuar, monitoruar dhe menaxhuar risqet e përgjithshme të biznesit, duke përfshirë humbjet nga ekzekutimi i dobët i strategjisë së biznesit, flukset monetare dhe shpenzimet operative.

Neni 53

Risqet operacionale

1. DQT duhet të identifikojë burimet e riskut operacional, si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm, dhe të minimizojë ndikimin e tyre nëpërmjet vënies në zbatim të mjeteve, kontrolleve dhe procedurave të përshtatshme të TI-së, duke përfshirë të gjitha sistemet e shlyerjes së titujve që ajo operon.
2. DQT duhet të ketë në dispozicion mjete të përshtatshme TI që sigurojnë një shkallë të lartë sigurie dhe besueshmërie operacionale dhe kanë kapacitet të përshtatshëm. Mjetet e TI-së duhet të trajtojnë në mënyrë adekuate kompleksitetin, shumëllojshmërinë dhe llojin e shërbimeve dhe aktiviteteve që kryhen për të garantuar standarde të larta sigurie, si dhe integritetin dhe konfidencialitetin e informacionit që ruhet.
3. Për shërbimet që ofron, si dhe për çdo sistem të shlyerjes së titujve që operon, DQT do të krijojë, zbatojë dhe mbajë një politikë të përshtatshme për vazhdimësinë e biznesit dhe planin e rikuperimit nga fatkeqësitë për të siguruar ruajtjen e shërbimeve të saj, rikuperimin në kohë të operacioneve, si dhe përmbushjen e detyrimeve të DQT-së në rast ngjarjesh që paraqesin një risk të konsiderueshëm për ndërprerjen e operacioneve.
4. Plani i referuar në pikën 3, të këtij neni do të parashikojë rikuperimin e të gjitha transaksioneve dhe pozicioneve të pjesëmarrësve në momentin e ndërprerjes për t'i lejuar pjesëmarrësit të një DQT-je të vazhdojnë të operojnë me siguri dhe të realizojnë shlyerjen në datën e planifikuar, duke përfshirë sigurimin se sistemet kritike të TI-së mund të rifillojnë brenda 24 orësh funksionimin që nga momenti i ndërprerjes. Ai duhet të përfshijë ngritjen e një vendi të dytë përpunimi me burime, aftësi, dhe funksionalitete të mjaftueshme dhe aranzhime të përshtatshme të personelit.
5. DQT duhet të planifikojë dhe realizojë një program testimesh për aranzhimet e referuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni.
6. DQT duhet të identifikojë, monitorojë dhe menaxhojë risqet që pjesëmarrësit kryesorë në sistemet e shlyerjes së titujve që ajo operon, si dhe ofruesit e shërbimeve, si dhe DQT-ë të tjera ose infrastruktura të tjera të tregut mund të paraqesin për operacionet e saj. Ajo, sipas kërkesës, do t'u japë autoriteteve kompetente dhe përkatëse informacione mbi çdo risk të tillë të identifikuar.
7. DQT informon gjithashtu Autoritetin pa vonesë për çdo incident operacional që rezulton nga këto risqe.
8. Autoriteti mund të specifikojë risqet operacionale të referuara në pikat 1 dhe 6 të këtij neni dhe metodat për të testuar, adresuar ose minimizuar ato risqe, duke përfshirë politikat e vazhdimësisë së biznesit dhe planet e rikuperimit nga fatkeqësitë, të referuara në pikat 3 dhe

4 dhe metodat e vlerësimit të tyre me anë të rregullores.

Neni 54 **Politika e investimeve**

1. DQT mban aktivet e saj financiare në bankat qendrore, banka të licencuara ose DQT të licencuara.
2. DQT duhet të ketë akses të shpejtë në asetet e saj, aty ku kërkohet.
3. DQT duhet të investojë burimet e saj financiare vetëm në para *cash* ose në instrumente financiare me likuiditet të lartë me risk minimal tregu dhe krediti. Këto investime do të mund të likuidohen me shpejtësi me efekt minimal të pafavorshëm në çmim.
4. Shuma e kapitalit, duke përfshirë fitimet e pashpërndara dhe rezervat e një DQT, të cilat nuk investohen në përputhje me pikën 3 të këtij neni, nuk do të merren parasysh për qëllimet e nenit 55, pika 1, të kësaj rregulloreje.
5. DQT duhet të sigurojë se ekspozimi i riskut të saj të përgjithshëm ndaj çdo banke të licencuar ose DQT-je të autorizuar, me të cilën ajo mban aktivet e saj financiare do të mbetet brenda kufijve të pranueshëm të përqendrimit.

Neni 55 **Kërkesat për kapital**

1. Kapitali, së bashku me fitimet e pashpërndara dhe rezervat e një DQT-je, duhet të jetë në përpjesëtim me risqet që rrjedhin nga veprimtaritë e DQT-së. Kapitali duhet të jetë në çdo kohë i mjaftueshëm që:
 - a) Të sigurohet se DQT është e mbrojtur në mënyrën e duhur ndaj risqeve operationale, ligjore, të kujdestarisë, investimeve dhe të biznesit, në mënyrë që DQT të mund të vazhdojë ofrimin e shërbimeve në vijim;
 - b) Të sigurohet një mbyllje ose ristrukturim i plotë i veprimtarive DQT-së për një hark kohor të përshtatshëm prej të paktën gjashtë muajsh nën një sërë skenarësh stresi.
2. DQT duhet të ketë një plan për sa vijon:
 - a) Ngritjen e kapitalit shtesë nëse qasja e saj ndaj kapitalit i afrohet ose bie nën kriteret e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni,
 - b) Sigurimin e mbylljes ose ristrukturimit të rregullt të veprimtarive dhe shërbimeve të saj kur DQT nuk mund të mbledhë kapital të ri.

Plani duhet të miratohet nga organi drejtues ose komiteti përkatës i organit drejtues dhe duhet të përditësohet rregullisht. Plani i përditësuar i paraqitet Autoritetit, i cili mund t'i kërkojë DQT-së të marrë masa shtesë ose të hartojë ndonjë dispozitë alternative kur Autoriteti konsideron se plani i DQT-së është i pamjaftueshëm .

Neni 56

Autorizimi për ofrimin e shërbimeve ndihmëse të tipit bankar për pjesëmarrësit e DQT

DQT nuk duhet të ofrojë asnjë shërbim ndihmës të tipit bankar të përcaktuar në nenin 214 të Ligjit, pa marrë një autorizim shtesë në përputhje me ligjin në fuqi “Për bankat”.

KREU V KOMPETENCAT E AUTORITETIT

Neni 57

Publikimi i vendimeve

1. Autoriteti publikon në faqen e tij zyrtare një ekstrakt të çdo vendimi që vendos sanksionin administrativ ose masa të tjera për shkelje të Ligjit dhe kësaj rregulloreje pa vonesa pasi personi i sanksionuar të jetë njoftuar për atë vendim. Publikimi duhet të përfshijë të paktën informacion për llojin dhe natyrën e shkeljes dhe identitetin e personit fizik ose juridik ndaj të cilit është vendosur sanksioni.
2. Kur publikimi i identitetit të personave juridikë ose i të dhënave personale të personave fizikë konsiderohet nga Autoriteti si jo proporcional pas një vlerësimi të kryer rast pas rasti ose kur publikimi rrezikon stabilitetin e tregjeve financiare ose një hetim në vazhdim, Autoriteti:
 - a) Pezullon publikimin e vendimit të sanksionit ose masës tjetër deri në momentin kur pushojnë së ekzistuari shkaqet që pengojnë publikimin;
 - b) Publikon vendimin për vendosjen e sanksionit ose masës tjetër duke ruajtur anonimatit në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - c) Nuk do të publikojë vendimin për vendosjen e sanksionit ose masës tjetër.
3. Autoriteti do të sigurojë që çdo publikim, në përputhje me këtë nen, të mbetet në faqen e tij zyrtare të internetit për një periudhë të paktën pesëvjeçare pas publikimit të tij. Të dhënat personale të përfshira në publikim do të mbahen në faqen zyrtare vetëm për periudhën e nevojshme sipas rregullave në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

Neni 58

Zbatimi efikas i sanksioneve

Autoriteti gjatë përcaktimit të llojit të sanksionit administrativ ose masave të tjera, duhet të marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, duke përfshirë, sipas rastit:

- a) Peshën dhe kohëzgjatjen e shkeljes;
- b) Shkallën e përgjegjësisë së personit përgjegjës për shkeljen;
- c) Pozicionin financiar ose të ardhurat vjetore të personit fizik ose juridik përgjegjës për shkeljen;
- d) Rëndësinë e fitimeve të fituara, humbjet e shmangura nga personi përgjegjës për shkeljen ose humbjet për palët e treta që rrjedhin nga shkelja, për aq sa mund të përcaktohen;
- e) Nivelin e bashkëpunimit të personit përgjegjës me Autoritetin për të shmangur humbjen

- ose rekuperuar pasojat e shkeljes;
- f) Shkeljet e mëparshme nga personi përgjegjës për shkeljen.

Neni 59
E drejta për ankim

Autoriteti arsyeton çdo vendim që parashikon sanksion administrativ. Vendimet e Autoritetit mund të ankimohen në gjykatë.

KREU VI
KËRKESA PËR RAPORTIM

Neni 60
Kërkesa për raportim tek Autoriteti

1. DQT i nënshtrohet kërkesave për raportim tek Autoriteti, siç përcaktohet në dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Autoriteti krijon mekanizma efikase për të inkurajuar raportimin e shkeljeve ose shkeljeve faktike ndaj Autoritetit nëpërmjet rregullores.

KREU VII
REFUZIMI DHE HEQJA E LICENCËS

Neni 61
Refuzimi i licencës

Autoriteti mund të refuzojë licencën në bazë të nenit 225 të Ligjit.

Neni 62
Heqja e licencës

1. Përveç nenit 227 të Ligjit, Autoriteti heq licencën në cilëndo nga rrethanat e mëposhtme, kur DQT:
 - a) Nuk ka përdorur licencën për 12 muaj, heq dorë shprehimisht nga licenca ose nuk ka ofruar shërbime ose nuk ka kryer asnjë aktivitet gjatë 6 muajve të mëparshëm;
 - b) Është licencuar mbi bazën e deklaratave të rreme ose me çfarëdo mjeti tjetër të paligjshëm;
 - c) Nuk përmbush më kushtet në të cilat është dhënë autorizimi dhe nuk ka ndërmarrë veprimet korrigjuese të kërkuara nga Autoriteti brenda një afati kohor të caktuar;
 - d) Ka shkelur seriozisht ose sistematikisht kriteret e përcaktuara në këtë rregullore ose, sipas rastit, në rregulloren në fuqi për ushtrimin e veprimtarisë operationale të shoqërive komisionere ose në rregulloren për kërkesat e transparencës së shoqërive të listuara.

2. Autoriteti mund të heqë licencën pjesërisht për një shërbim, veprimtari ose instrument financiar të caktuar.
3. DQT duhet të vendosë dhe zbatojë procedurat e duhura që sigurojnë shlyerjen dhe transferimin në kohë dhe të rregullt të aktiveve të klientëve dhe pjesëmarrësve në një DQT tjetër të licencuar ose të njohur në Republikën e Shqipërisë, ose si mjete i fundit juridik i njohur në Bashkimin Evropian, në rast të tërheqjes së autorizimit të referuar në pikën 1, të këtij neni.

Neni 63
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2024.

SHTOJCA I
FORMULARI DHE PËRMBAJTJA E APLIKIMIT TË NJË DQT-JE PËR LICENCIM

Tabela 1
Informacione të përgjithshme

Lloji i informacionit	Formati
Data e aplikimit	VVVV-MM-DD
Emri i shoqërisë së DQT- së aplikuese	Tekst i lirë
Identifikimi i DQT- së aplikuese	NIPT
Adresa e regjistruar e DQT- së aplikuese	Tekst i lirë
Sistemi(et) e shlyerjes së titujve që DQT aplikuese vë në funksion ose synon të vendosë në funksion	Tekst i lirë
Të dhënat e kontaktit të personit përgjegjës për aplikimin (emri, funksioni, numri i telefonit, adresa e emailit)	Tekst i lirë
Të dhënat e kontaktit të personit përgjegjës për kontrollin e brendshëm dhe funksionin e pajtueshmërisë së DQT-së aplikuese (emri, funksioni, numri i telefonit, adresa e emailit)	Tekst i lirë
Lista e të gjitha dokumenteve të dhëna nga DQT aplikuese	Tekst i lirë

Tabela 2
Referencat e dokumenteve

Objekti i informacionit që duhet të dorëzohet në përputhje me këtë Rregullore	Referenca e dokumentit	Titulli i dokumentit	Kapitulli ose seksioni ose faqja e dokumentit ku jepet informacioni ose arsyeja pse informacioni nuk jepet
Informacione të përgjithshme për DQT-në aplikuese (Nenet 10 dhe 11 të Rregullores)			
<i>Identifikimi dhe statusi ligjor i DQT-së (Neni 10 i kësaj rregulloreje)</i>			
Aplikimi për licencim i paraqitur sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje duhet të identifikojë qartësisht subjektin që zbaton aktivitetet dhe shërbimet që synon të kryejë			
Emri i shoqërisë së DQT-së aplikuese, NIPT-in e tij dhe adresën zyrtare			
Memorandumi dhe statuti dhe dokumentacion tjetër kushtetues dhe statutor			
Një ekstrakt nga regjistri përkatës tregtar ose gjyqësor, ose forma të tjera të provave të vërtetuara të adresës ligjore dhe veprimtarisë së biznesit të DQT-së aplikuese që do të jenë të vlefshme në datën e aplikimit			
Identifikimi i sistemeve të shlyerjes së titujve që operon ose synon të operojë DQT aplikuese			

<p>Një kopje e vendimit të organit drejtues në lidhje me aplikimin dhe procesverbalin e mbledhjes në të cilën organi drejtues ka miratuar dosjen e aplikimit dhe paraqitjen e saj</p>			
<p>Të dhënat e kontaktit të personit përgjegjës për aplikimin</p>			
<p>Një listë që përmban:</p> <p>(i)Emrin e çdo personi ose subjekti që, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, zotëron 5% ose më shumë të kapitalit ose të drejtave të votës të DQT-së aplikuese;</p> <p>(ii)Emrin e çdo personi ose subjekti që mund të ushtrojë një ndikim të rëndësishëm mbi menaxhimin e DQT-së aplikuese për shkak të zotërimit të tij në kapitalin e DQT-së aplikuese</p>			
<p>Një listë që përmban:</p> <p>(i) Emrin e çdo subjekti në të cilin DQT aplikuese zotëron 5% ose më shumë të kapitalit të njësisë ekonomike dhe të drejtave të votës;</p> <p>(ii)Emrin e çdo subjekti mbi menaxhimin e të cilit DQT aplikuese ushtron një ndikim të</p>			

rëndësishëm, duke pasur parasysh zotërimin e kapitalit të njësisë ekonomike nga DQT aplikuese			
Një listë e shërbimeve bazë në përputhje me nenin 5, pika 2, të kësaj rregulloreje			
Një listë e shërbimeve ndihmëse të renditura në mënyrë të shprehur në nenin 212 të Ligjit që DQT aplikuese ofron ose synon të ofrojë			
Një listë e shërbimeve që DQT aplikuese kontraktin ose synon t'ia kontraktojë një pale të tretë në përputhje me nenin 43 të kësaj rregulloreje			
Monedha ose monedhat që DQT aplikuese përpunon ose synon të përpunojë në lidhje me shërbimet që ofron DQT aplikuese, pavarësisht nëse paratë shlyhen në një llogari të bankës qendrore, një llogari DQT, ose një llogari në një bankë të caktuar			
Informacionet mbi çdo proces gjyqësor ose civil, administrativ dhe arbitrazh në proces dhe ato që kanë marrë vendim të formës së prerë ose çdo proces tjetër ligjor në të cilin DQT aplikuese është			

palë dhe që mund t'i shkaktojë kosto financiare ose të tjera.			
<i>Politikat dhe procedurat për pajtueshmërinë rregullatore (Neni 11 i kësaj rregulloreje)</i>			
Titujt e punës së personave përgjegjës për miratimin dhe mirëmbajtjen e politikave dhe procedurave			
Një përshkrim i masave që zbatojnë dhe monitorojnë përputhshmërinë me politikat dhe procedurat			
Një përshkrim i procedurave të vëna në zbatim nga DQT aplikuese në përputhje me çdo mekanizëm të vendosur në përputhje me këtë rregullore.			
<i>Shërbimet dhe aktivitetet e DQT-së (Neni 211 dhe 212 i Ligjit)</i>			
Përshkrime të hollësishme të shërbimeve dhe aktiviteteve, si dhe të procedurave që do të zbatohen në ofrimin e shërbimeve dhe aktiviteteve nga DQT aplikuese:			
Shërbimet bazë të përcaktuara në nenin 211 të Ligjit			
Shërbimet ndihmëse të renditura shprehimisht në nenin 212 të Ligjit			
Burimet financiare për ofrimin e shërbimeve nga DQT aplikuese (Neni 12 i Rregullores)			
<i>Raportet financiare, plani i biznesit dhe plani i rikuperimit (Neni 12 i Rregullores)</i>			

Raportet financiare duke përfshirë një grup të plotë të pasqyrave financiare për tre vitet e mëparshme, si dhe raportin e auditimit ligjor mbi pasqyrat financiare vjetore dhe të konsoliduara për tre vitet e mëparshme			
Identifikimi i audituesit të jashtëm			
Një plan biznesi, duke përfshirë një plan financiar dhe një buxhet të vlerësuar, që parashikon skenarë të ndryshëm biznesi për shërbimet e DQT-së, për një periudhë referimi prej të paktën tre vjetësh			
Një përshkrim i aktiviteteve të biznesit që DQT aplikuese planifikon të kryejë, duke përfshirë aktivitetet e çdo filiali ose dege të DQT-së aplikuese			
<i>Kur informacioni financiar historik i përmendur më sipër nuk është i disponueshëm, aplikim për licencim do të përmbajë informacionin e mëposhtëm në lidhje me DQT-në aplikuese:</i>			
Evidencë që dëshmon burime të mjaftueshme financiare gjatë gjashtë muajve pas dhënies së licencimit			
Një raport financiar i ndërmjetëm			

Një deklaratë në lidhje me situatën financiare të DQT-së aplikuese, si bilanci, pasqyra e të ardhurave, ndryshimet në kapital dhe flukset monetare dhe një përmbledhje e politikave kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese përkatëse			
<i>Një përshkrim i një plani të përshtatshëm rikuperimi, duke përfshirë:</i>			
Një përmbledhje që ofron një pasqyrë të planit dhe zbatimit të tij			
Një identifikim i operacioneve kritike të DQT-së aplikuese, skenarëve të stresit dhe ngjarjeve që sjellin rikuperim dhe një përshkrim thelbësor të mjeteve të rikuperimit që do të përdoren nga DQT aplikuese			
Informacion në lidhje me vlerësimin e çdo ndikimi të planit të rikuperimit në palë të ndryshme të interesuara që mund të ndikohen nga zbatimi i tij			
Kriteret organizative (Nenet 13 deri 17 të Rregullores)			
<i>Skema organizative (Neni 13 i Rregullores)</i>			
Identiteti dhe detyrat e personave përgjegjës për pozicionet e mëposhtme: (i) Menaxhimi i lartë			

(ii) Këshilli mbikëqyrës			
(iii) Role të tjera të rëndësishme në operacionet e DQT-së aplikuese.			
Numri i anëtarëve të stafit në çdo divizion dhe njësi operative			
<i>Mjetet e monitorimit të riskut dhe aranzhimet qeverisëse (Neni 14 i kësaj rregulloreje)</i>			
Një përshkrim i komponentëve të aranzhimeve qeverisëse të DQT-së aplikuese			
Politikat, procedurat dhe sistemet e vendosura në përputhje me nenin 41 të rregullores			
Një përshkrim i përbërjes, rolit dhe përgjegjësisë të anëtarëve të organit drejtues dhe menaxhimit të lartë dhe çdo komiteti të krijuar në përputhje me këtë rregullore			
Një përshkrim i proceseve në lidhje me përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e performancës dhe largimin e menaxhimit të lartë dhe anëtarëve të organit drejtues			
Një përshkrim i procedurës së përdorur nga DQT aplikuese për të vënë në dispozicion të publikut rregullimet e saj			

të qeverisjes dhe rregullat që rregullojnë veprimtarinë e saj			
<i>Menaxhimi i lartë, organi drejtues, bordi mbikëqyrës dhe aksionarët (Neni 15 i Rregullores)</i>			
Për çdo anëtar të menaxhimit të lartë dhe anëtar të organit drejtues, informacionet e mëposhtme:			
Një kopje e një Curriculum Vitae, e cila përcakton përvojën dhe njohuritë e secilit anëtar			
Detaje në lidhje me çdo sanksion penal dhe administrativ të vendosur ndaj një anëtari në lidhje me ofrimin e shërbimeve financiare ose të dhënave ose në lidhje me aktet e mashtrimit ose shpërdorimit të fondeve në formën e një vërtetimi zyrtar të përshtatshëm kur është e mundur			
Një vetëdeklarim mbi reputacionin e mirë në lidhje me ofrimin e një shërbimi financiar ose të të dhënave, duke përfshirë të gjitha deklaratat që jepen në nenin 15 të rregullores			
<i>Informacione në lidhje me organin drejtues të DQT-së aplikuese</i>			
Një evidencë të pajtueshmërisë me këtë rregullore			

Një përshkrim të roleve dhe përgjegjësive të organit drejtues			
<i>Informacione në lidhje me organin mbikëqyrës të DQT-së aplikuese</i>			
Një evidencë të pajtueshmërisë me nenin 43, pika 3 të Rregullores			
<i>Informacione në lidhje me strukturën e pronësisë dhe aksionarët e DQT-së aplikuese</i>			
Një përshkrim të strukturës së pronësisë së DQT-së aplikuese, duke përfshirë një përshkrim të identitetit dhe madhësisë së interesave të çdo subjekti që është në një pozicion të tillë që mund të ushtrojë kontroll mbi funksionimin e DQT-së aplikuese			
Një listë aksionarësh dhe personash që janë në një pozicion të tillë që mund të ushtrojnë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, kontrollin mbi menaxhimin e DQT-së aplikuese			
<i>Konfidencialiteti (Neni 16 i Rregullores)</i>			
Politikat dhe procedurat që parandalojnë përdorimin ose zbulimin e paautorizuar të informacionit konfidencial siç përcaktohet në nenin 16 të rregullores.			

Informacione në lidhje me aksesin e personelit në informacionet që mbahen nga DQT aplikuese:			
Procedurat e brendshme në lidhje me lejet e aksesit të personelit në informacione që sigurojnë akses të sigurt në të dhëna			
Një përshkrim të çdo kufizimi në përdorimin e të dhënave për arsye konfidencialiteti			
<i>Komiteti i përdoruesve (Neni 17 i Rregullores)</i>			
Dokumentet ose informacionet për çdo Komitet përdoruesi:			
Mandati i Komitetit të përdoruesve			
Rregullimet qeverisëse të Komitetit të përdoruesve			
Procedurat e funksionimit të Komitetit të përdoruesve			
Kriteret e pranimit dhe mekanizmi i zgjedhjes për anëtarët e Komisionit të përdoruesve			
Një listë e anëtarëve të propozuar të Komitetit të përdoruesve dhe treguesit e interesave që ata përfaqësojnë			
<i>Kriteret për pjesëmarrje</i>			

(Neni 18 i Rregullores)

Informacione në lidhje me pjesëmarrjen në sistemin(et) e shlyerjes së titujve që operohet nga DQT aplikuese:

Kriteret e pjesëmarrjes që lejojnë akses të drejtë dhe të hapur për të gjithë personat juridikë që synojnë të bëhen pjesëmarrës në sistemin(et) e shlyerjes së titujve që operohet nga DQT aplikuese

Procedurat për zbatimin e masave disiplinore ndaj pjesëmarrësve ekzistues që nuk plotësojnë kriteret e pjesëmarrjes

***Transparenca
(Neni 19 i Rregullores)***

Informacione mbi politikën e çmimeve të DQT-së aplikuese duke përfshirë në veçanti çmimet dhe tarifatat për çdo shërbim bazë që ofrohet nga DQT aplikuese dhe çdo zbritje dhe ulje ekzistuese, si dhe kushtet për ulje të tilla

Një përshkrim të metodave të përdorura për të zbuluar informacionin përkatës për klientët dhe klientët e mundshëm në përputhje me nenin 221 të Ligjit

Informacione që lejojnë autoritetin kompetent të vlerësojë se si DQT synon të përmbushë kriteret për të llogaritur veçmas kostot dhe të ardhurat në përputhje me nenin 221 të Ligjit			
Formulari i regjistrimit në libër (Neni 20 i Rregullores)			
Informacione në lidhje me proceset që sigurojnë përputhshmërinë e DQT-së aplikuese me nenet 215 dhe 216 të Ligjit			
Datat e synuara të shlyerjes dhe masat për parandalimin dhe adresimin e mosrealizimeve të shlyerjes (Neni 21 i Rregullores)			
Rregullat dhe procedurat në lidhje me masat për të parandaluar mosrealizimin e shlyerjes			
Detajet e masave për adresimin e mosrealizimit të shlyerjes			
Integriteti i emetimit (Neni 22 i Rregullores)			
Informacione në lidhje me rregullat dhe procedurat e DQT-së për garantimin e integritetit të emetimeve të titujve			
Mbrojtja e titujve të pjesëmarrësve dhe klientëve të tyre (Neni 23 i Rregullores)			

Informacione në lidhje me masat e vëna në zbatim për të siguruar mbrojtjen e titujve të pjesëmarrësve të DQT-së aplikuese dhe të klientëve të tyre, duke përfshirë:			
Rregullat dhe procedurat për të reduktuar dhe menaxhuar risqet që lidhen me ruajtjen e titujve			
Përshkrim i detajuar i niveleve të ndryshme të ndarjes të ofruara nga DQT aplikuese, duke përfshirë një përshkrim të kostove të lidhura me çdo nivel, kushtet tregtare në të cilat ato ofrohen, implikimet e tyre kryesore ligjore dhe ligjin e zbatueshëm për falimentimin			
Rregullat dhe procedurat për marrjen e miratimeve të referuara në këtë rregullore			
<i>Përfundimi i shlyerjes (Neni 24 i Rregullores)</i>			
Informacione në lidhje me rregullat për përfundimin e shlyerjes			
<i>Pagesa në cash (Neni 25 i Rregullores)</i>			
Procedurat për shlyerjen e pagesave në “cash” për çdo sistem shlyerjeje të titujve që operon DQT aplikuese			
Informacione nëse shlyerja e pagesave në			

para kryhet në përputhje me këtë rregullore			
Kur është e aplikueshme, shpjegimi i arsyes së shlyerjes në përputhje me këtë rregullore			
<i>Rregullat dhe procedurat e mosrealizimit nga ana e pjesëmarrësve (Neni 26 i Rregullores)</i>			
Rregullat dhe procedurat e vëna në zbatim për të menaxhuar mosrealizimin nga ana e një pjesëmarrësi			
<i>Risqet ligjore (Neni 27 i Rregullores)</i>			
Informacione që i mundësojnë Autoritetit kompetent të vlerësojë se rregullat, procedurat dhe kontratat e DQT-së aplikuese janë të qarta, të kuptueshme dhe të zbatueshme në përputhje me këtë rregullore			
<i>Risqet e përgjithshme të biznesit (Neni 28 i Rregullores)</i>			
Një përshkrim i sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të riskut, si dhe mjeteve të TI-së të vëna në zbatim nga DQT për të menaxhuar risqet e biznesit			
Kur është e aplikueshme, vlerësimi i			

riskut i marrë nga një palë e tretë, duke përfshirë çdo informacion përkatës që mbështet atë vlerësim risku			
<i>Risqet operationale (Neni 29 i Rregullores)</i>			
Dëshmi që tregon se DQT aplikuese vepron në përputhje me kriterin për menaxhimin e risqeve operationale në përputhje me këtë rregullore			
Informacione në lidhje me kontraktimin e jashtëm të shërbimeve ose aktiviteteve nga DQT aplikante tek palët e treta			
<i>Politika e investimeve (Neni 30 i Rregullores)</i>			
Evidencë që demonstroi se: (a) DQT aplikuese mban aktivitetet e saj financiare në përputhje me këtë rregullore (b) investimet e DQT-së aplikuese janë në përputhje me këtë rregullore			
<i>Kërkesat për kapital (Neni 31 i Rregullores)</i>			
Informacione që tregojnë se kapitali i DQT-së			

aplikuese, duke përfshirë fitimet e pashpërndara dhe rezervat e DQT-së aplikuese, plotëson kriteret e nenit 55 të rregullores			
Plani i referuar në nenin 55, pika 2, të rregullores dhe çdo përditësim i atij plani, si dhe evidenca e miratimit të tij nga organi drejtues ose një Komitet përkatës i organit drejtues të DQT-së aplikuese			
<i>Akresi në DQT</i> <i>(Neni 32 i Rregullores)</i>			
Një përshkrim i procedurave për trajtimin e kërkesave për akses nga:			
Personat juridikë që dëshirojnë të bëhen pjesëmarrës në përputhje me nenin 220 të Ligjit			
Infrastrukturat e tjera të tregut në përputhje me nenin 223 të Ligjit			
<i>Informacione shtesë</i> <i>(Neni 33 i Rregullores)</i>			
Çdo informacion shtesë i nevojshëm për të vlerësuar nëse, në momentin e autorizimit, DQT aplikuese është në përputhje me kriteret e Ligjit dhe Rregullores			

SHTOJCA II

Forma dhe përmbajtja e të dhënave të regjistruara

Tabela 1

Të dhënat e shërbimeve ndihmëse

Nr.	Shërbimet ndihmëse sipas nenit 212 të Ligjit	Llojet e të dhënave	Formati
1	Organizimi i një mekanizmi të huadhënies së titujve, si agjent ndërmjet pjesëmarrësve të një sistemi të shlyerjes së titujve	<ul style="list-style-type: none"> a) Identifikimi i palëve dorëzuese/marrëse, b) Detajet në lidhje me çdo operacion huadhënieje/huamarrjeje të titujve, duke përfshirë vëllimin dhe vlerën e titujve të dhëna ose huazuara, ISIN, c) Qëllimi i çdo operacioni huadhënieje/huamarrjeje të titujve, d) Llojet e kolateralit, e) Vlerësimi i kolateralit. 	Dosjet, dokumentet
2	Ofrimi i shërbimeve të menaxhimit të kolateralit, si agjent për pjesëmarrësit në një sistem shlyerjeje të titujve	<ul style="list-style-type: none"> a) Identifikimi i palëve dorëzuese/marrëse, b) Detajet në lidhje me çdo operacion, duke përfshirë vëllimin dhe vlerën e titujve, ISIN, c) Llojet e kolateralit të përdorur, d) Qëllimi i përdorimit të kolateralit, 	Dosjet, dokumentet

		e) Vlerësimi i kolateralit.	
3	Përputhja e shlyerjeve, drejtimi i udhëzimeve, konfirmimi i tregtimit, verifikimi i tregtimit	a) Identifikimi i subjekteve për të cilat DQT aplikuese ofron shërbime, b) Llojet e veprimtarive, c) Detaje në lidhje me çdo operacion, duke përfshirë vëllimin dhe vlerën e titujve në shërbim, ISIN.	Dosjet, dokumentet
4	Shërbimet që lidhen me regjistrat e aksionarëve	a) Identifikimi i subjekteve për të cilat DQT ofron shërbime, b) Llojet e shërbimeve, c) Detaje në lidhje me çdo operacion, duke përfshirë vëllimin dhe vlerën e titujve në shërbim, ISIN.	Dosjet, dokumentet
5	Mbështetja e përpunimit të veprimeve të korporatave, duke përfshirë shërbimet tatimore, mbledhjet e përgjithshme dhe informacioneve	a) Identifikimi i subjekteve për të cilat DQT ofron shërbime, b) Llojet e shërbimeve, c) Detaje në lidhje me çdo operacion, duke përfshirë vëllimin dhe vlerën e titujve/cash-it në shërbim, përfituesit e operacionit, ISIN.	Dosjet, dokumentet
6	Shërbime të reja emetimi, duke përfshirë alokimin dhe menaxhimin e kodeve ISIN dhe kodeve të ngjashme	a) Identifikimi i subjekteve për të cilat DQT ofron shërbime,	Dosjet, dokumentet

		<p>b) Llojet e shërbimeve,</p> <p>c) Detaje në lidhje me çdo operacion, duke përfshirë ISIN.</p>	
7	Drejtimi dhe përpunimi i udhëzimeve, mbledhja dhe përpunimi i tarifave dhe raportimi përkatës	<p>a) Identifikimi i subjekteve për të cilat DQT ofron shërbime,</p> <p>b) Llojet e shërbimeve,</p> <p>c) Detaje në lidhje me çdo operacion, duke përfshirë vëllimin dhe vlerën e titujve /cash-it në shërbim, përfituesit e operacionit, ISIN, qëllimin e operacionit.</p>	Dosjet, dokumentet
8	Krijimi i lidhjeve të DQT-së, ofrimi, mbajtja ose funksionimi i llogarive të titujve në lidhje me shërbimin e shlyerjes, menaxhimin e kolateralit, shërbime të tjera ndihmëse	<p>a) Detaje për sa u takon lidhjeve të DQT-së, duke përfshirë identifikimin e DQT-e,</p> <p>b) Llojet e shërbimeve.</p>	Dosjet, dokumentet
9	Ofrimi i shërbimeve të përgjithshme për menaxhimin e kolateralit si agjent	<p>a) Identifikimi i palëve dorëzuese/marrëse,</p> <p>b) Detajet në lidhje me çdo operacion, duke përfshirë vëllimin dhe vlerën e titujve në shërbim, ISIN,</p> <p>c) Llojet e kolateralit,</p> <p>d) Qëllimi i përdorimit të kolateralit,</p> <p>e) Vlerësimi i kolateralit.</p>	Dosjet, dokumentet

10	Ofrimi i raportimit rregullator	<p>a) Identifikimi i subjekteve për të cilat DQT ofron shërbime raportimi,</p> <p>b) Llojet e shërbimeve,</p> <p>c) Detaje në lidhje me të dhënat e ofruara, duke përfshirë bazën ligjore dhe qëllimin.</p>	Dosjet, dokumentet
11	Ofrimi i informacionit, të dhënave dhe statistikave për zyrat e tregut/regjistrimit ose subjektet e tjera qeveritare ose ndërqeveritare	<p>a) Identifikimi i subjekteve për të cilat DQT ofron shërbime,</p> <p>b) Llojet e shërbimeve,</p> <p>c) Detaje në lidhje me të dhënat e ofruara, duke përfshirë bazën ligjore dhe qëllimin.</p>	Dosjet, dokumentet
12	Ofrimi i shërbimeve të TI-së	<p>a) Identifikimi i subjekteve për të cilat DQT ofron shërbime,</p> <p>b) Llojet e shërbimeve,</p> <p>c) Detaje në lidhje me shërbimet e TI-së.</p>	Dosjet, dokumentet
13	Garancitë dhe angazhimet në lidhje me huadhënien dhe huamarrjen e titujve	<p>a) Identifikimi i subjekteve për të cilat DQT ofron shërbime,</p> <p>b) Llojet e shërbimeve,</p> <p>c) Detaje në lidhje me çdo operacion, duke përfshirë vëllimin dhe vlerën e titujve/cash-it, dhe qëllimin e operacionit.</p>	Dosjet, dokumentet

Tabela 2
Të dhënat e biznesit

Nr.	Zëri	Formati	Përshkrimi
1	Skema organizative	Skema	Organi drejtues, menaxhimi i lartë, Komitetet përkatëse, njësitë operative dhe të gjitha njësitë ose divizionet e tjera të DQT-së.
2	Identitetet e aksionarëve ose personave (persona fizikë ose juridikë), që ushtrojnë kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi menaxhimin e DQT-së ose që kanë pjesëmarrje në kapitalin e DQT-së dhe shumat e këtyre zotërimeve	A = Aksionari/ M = Anëtari D=Drejtpërdrejtë I = Jo drejtpërdrejtë N = Person fizik/ L = Person juridik	Aksionarët ose personat që ushtrojnë kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi menaxhimin (administrimin) e DQT-së ose kanë pjesëmarrje në kapitalin e DQT-së (fushat që duhen shtuar për çdo aksionar/person përkatës)
3	Dokumentet që vërtetojnë politikat, procedurat dhe proceset e kërkuara sipas kritereve organizative të DQT-së dhe në lidhje me shërbimet e ofruara nga DQT-ja	Dosjet, dokumentet	
4	Procesverbalet e mbledhjeve të organeve drejtuese dhe të mbledhjeve të Komiteteve të menaxhimit të lartë dhe komiteteve të tjera të DQT-së	Dosjet, dokumentet	
5	Procesverbalet e mbledhjeve të Komitetit(ve) të përdoruesve	Dosjet, dokumentet	
6	Procesverbalet e takimeve me grupe konsultimi të përbëra nga pjesëmarrës dhe klientë, nëse ka	Dosjet, dokumentet	

7	Raportet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, raportet e menaxhimit të riskut, raportet e pajtueshmërisë dhe kontrollit të brendshëm, duke përfshirë përgjigjet nga menaxhimi i lartë për raporte të tilla	Dosjet, dokumentet	
8	Të gjitha kontratat e kontraktimit	Dosjet, dokumentet	
9	Politika e vazhdimësisë së biznesit dhe plani i rimëkëmbjes nga fatkeqësitë	Dosjet, dokumentet	
10	Regjistrime që pasqyrojnë të gjitha aktivet dhe detyrimet dhe llogaritë kapitale të DQT-së	Dosjet, dokumentet	
11	Regjistrime që pasqyrojnë të gjitha kostot dhe të ardhurat, duke përfshirë kostot dhe të ardhurat të cilat llogariten veçmas në përputhje me nenin 34(6) të Rregullores (EU) Nr. 909/2014	Dosjet, dokumentet	
12	Ankesa zyrtare të marra	Tekst i lirë	Për çdo ankesë zyrtare: informacione mbi emrin dhe adresën e ankuesit; data e marrjes së ankesës; emrat e të gjithë personave të identifikuar në ankesë; përshkrimi i natyrës së ankesës; përmbajtjes dhe rezultatit të ankesës; dates së zgjidhjes së ankesës.
13	Informacione për çdo ndërprerje ose mosfunksionim të shërbimeve	Tekst i lirë	Regjistrimet e çdo ndërprerjeje ose mosfunksionimi të shërbimeve, duke përfshirë një raport të detajuar për kohën, efektet e një ndërprerjeje ose

			mosfunksionimi të tillë dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra
14	Regjistrime të rezultateve të testimeve të pasme dhe të stresit të kryera për DQT-të që ofrojnë shërbime ndihmëse të tipit bankar	Dosjet, dokumentet	
15	Komunikime me shkrim me Autoritetin	Dosjet, dokumentet	
16	Tarifat dhe honoraret e aplikuara për shërbime të ndryshme, duke përfshirë çdo zbritje ose ulje	Tekst i lirë	

SHTOJCA III

Modele për paraqitjen e informacioneve për shqyrtim dhe vlerësim

Tabela 1

Informacione të përgjithshme për t'u dhënë nga DQT-ja

Lloji i informacionit	Formati
Data e dorëzimit të informacionit	VVVV-MM-DD
Data e rishikimit dhe vlerësimit të fundit	VVVV-MM-DD
Emri i shoqërisë së DQT- së	Tekst i lirë
Identifikimi i DQT- së	NIPT
Adresa ligjore e DQT-së	Tekst i lirë
Sistemi(et) e shlyerjes së titujve që DQT vë në funksion	Tekst i lirë
Të dhënat e kontaktit të personit përgjegjës për procesin e rishikimit dhe vlerësimit (emri, funksioni, numri i telefonit, adresa e email-it)	Tekst i lirë
Të dhënat e kontaktit të personit përgjegjës për kontrollin e brendshëm dhe funksionin e pajtueshmërisë së DQT-së (emri, funksioni, numri i telefonit, adresa e email-it)	Tekst i lirë
Lista e të gjitha dokumenteve të dhëna nga DQT	Tekst i lirë
Raport mbi aktivitetet e DQT-së dhe ndryshimet thelbësore të bëra gjatë periudhës së shqyrtimit, duke përfshirë një deklaratë të përputhshmërisë së përgjithshme me dispozitat e Ligjit dhe rregullores, duke përfshirë çdo ndryshim thelbësor	Dokument i veçantë

Tabela 2
Informacione në lidhje me ngjarjet periodike

Nr.	Lloji i informacionit
1	Një set i plotë i pasqyrave financiare më të fundit të audituara të DQT-së, duke përfshirë ato të konsoliduara në nivel grupi
2	Një version i përmbledhur i pasqyrave financiare të ndërmjetme më të fundit të DQT-së
3	Çdo vendim i organit menaxhues pas këshillës së Komitetit të përdoruesve, si dhe çdo vendim kur organi menaxhues ka vendosur të mos ndjekë këshillën e Komitetit të përdoruesve
4	Informacione mbi çdo proces civil, administrativ ose ndonjë proces tjetër gjyqësor ose jashtëgjyqësor në proces që përfshin DQT-në, veçanërisht në lidhje me çështjet në lidhje me tatimin dhe falimentimin, ose çështjet që mund të shkaktojnë kosto financiare ose reputacioni për DQT-në, si dhe çdo vendim i formës së prerë që rezulton nga këto procedura
5	Informacione mbi çdo proces civil, administrativ ose ndonjë tjetër gjyqësor ose jashtëgjyqësor në proces, që përfshin një anëtar të organit drejtues ose një anëtar të menaxhimit të lartë që mund të ketë një ndikim negativ në DQT, si dhe çdo vendim i formës së prerë që rezulton nga këto procedura
6	Një kopje e rezultateve të testimeve të stresit të vazhdimësisë së biznesit ose ushtrimeve të ngjashme të kryera gjatë periudhës së rishikimit
7	Një raport mbi incidentet operacionale që kanë ndodhur gjatë periudhës së shqyrtimit dhe kanë ndikuar në ofrimin e qetë të çdo shërbimi bazë të ofruar, masat e marra për t'i adresuar ato dhe rezultatet e tyre
8	Një raport mbi performancën e sistemit, duke përfshirë një vlerësim të disponueshmërisë së sistemit gjatë periudhës së rishikimit, disponueshmëria e sistemit do të matet çdo ditë si përqindje e kohës që sistemi është në dispozicion për shlyerje
9	Një përmbledhje e llojeve të ndërhyrjeve manuale të kryera nga DQT-ja
10	Informacione në lidhje me identifikimin e operacioneve kritike të DQT-së, çdo ndryshim thelbësor në planin e saj të rimëkëmbjes, rezultatet e skenarëve të stressit, nxitësit e rikuperimit dhe mjetet e rikuperimit të DQT-së
11	Informacione mbi çdo ankesë zyrtare të pranuar nga DQT gjatë periudhës së shqyrtimit

12	Informacione në lidhje me rastet kur DQT i ka refuzuar aksesin në shërbimet e saj çdo pjesëmarrësi ekzistues ose potencial, çdo emetuesi, një DQT-je tjetër ose një infrastrukturë tjetër tregu
13	Informacione në lidhje me të gjitha rastet e konflikteve të identifikuara të interesit që kanë ndodhur gjatë periudhës së shqyrtimit, duke përfshirë përshkrimin se si janë menaxhuar ato
14	Informacione në lidhje me kontrollet e brendshme dhe auditimet e kryera nga DQT gjatë periudhës së rishikimit
15	Informacione në lidhje me çdo shkelje të identifikuar të Ligjit dhe të kësaj Rregulloreje
16	Informacione të detajuara në lidhje me çdo veprim disiplinor të ndërmarrë nga DQT-ja, duke përfshirë çdo rast të pezullimit të pjesëmarrësve me një specifikim të periudhës së pezullimit dhe arsyen e një pezullimi të tillë
17	Strategjia e përgjithshme e biznesit të DQT-së që mbulon një periudhë prej të paktën tre vjetësh pas rishikimit dhe vlerësimit të fundit dhe një plan biznesi të detajuar për shërbimet e ofruara nga DQT që mbulon të paktën një periudhë prej një viti pas rishikimit dhe vlerësimit të fundit

Tabela 3
Të dhëna statistikore

Nr.	Lloji i të dhënave	
1	Lista e pjesëmarrësve në çdo sistem të shlyerjes së titujve që operohet nga DQT-ja, duke përfshirë informacionin për vendin e tyre të themelimit	NIPT

2	<p>Lista e emetuesve dhe një listë e emetimeve të titujve që mbahet nga DQT-ja, duke përfshirë informacionet për vendin e themelimit të emetuesit, si dhe një identifikim të emetuesve,</p>	<p>NIPT + Lloji i titullit + Emri i emetuesit</p>
3	<p>Vlera totale e tregut dhe vlera nominale e titujve të regjistruara në llogaritë e titujve që mbahen në nivel qendror dhe jo qendror në çdo sistem të shlyerjes së titujve që operohet nga DQT-ja</p>	<p>a) Vlera nominale e titujve: b) Vlera e tregut të titujve:</p>
5	<p>Vlera nominale dhe e tregut e titujve të regjistruara fillimisht në çdo sistem shlyerjeje të titujve që operohet (vihet në funksion) nga DQT-ja</p>	<p>a) Vlera nominale e titujve: b) Vlera e tregut të titujve:</p>

6	Numri dhe shuma e penaliteteve për çdo pjesëmarrës DQT-je	Për çdo pjesëmarrës DQT-je: a) Numri i penaliteteve: b) Shuma e penaliteteve:
7	Vlera totale e operacioneve të huamarrjes dhe huadhënies së titujve të përpunuara nga DQT që vepron si agjent dhe si principal, sipas rastit	Vlera totale e operacioneve të huamarrjes dhe huadhënies së titujve të përpunuara nga: a) DQT që vepron si agjent: b) DQT që vepron si principal:
8	Vlera e garancive dhe angazhimeve në lidhje me operacionet e huamarrjes dhe huadhënies së titujve	
9	Numri i problemeve të rakordimit të hasura sipas krijimit ose fshirjes së panevojshme të titujve në emetimin e mbajtur nga DQT	